ADEM ZAPLLUZHA

FLUTURAT E DJEGURA

ADEM ZAPLLUZHA

FLUTURAT E DJEGURA

Redaktor:
Azem Osmani

Recensent :
Azem Osmani

Lektor:
Veli Veliu

Piktura në ballinë :

Besim Lutolli - Beci

Redaktor:
Azem Osmani

Recensent :
Azem Osmani

Lektor:
Veli Veliu

Piktura në ballinë :

Besim Lutolli - Beci

ADEM ZAPLLUZHA

FLUTURAT E DJEGURA

Shtëpia botuese
TRENDI
Prishtinë 2019

ADEM ZAPLLUZHA

FLUTURAT E DJEGURA

Shtëpia botuese
TRENDI
Prishtinë 2019

ADEM ZAPLLUZHA

4

VËSHTRIM PËR VËLLIMIN POETIK "FLUTURAT E DJEGURA" TË POETIT ADEM ZAPLLUZHA

Poeti Adem Zaplluzha është një emër i njohur në letërsinë shqipe. Ky krijues deri më tani ka botuar 163 libra me poezi. Poeti një pjesë të mirë të jetës shpirtin e tij ia ka dhënë poezisë. Adem Zaplluzha është kreator i vargjeve të lira me një pasqyrim të qartë. Poezitë e tij kanë një kompozicion me nivel të kënaqshëm të strukturimit dhe me figura mirë të modeluara. Poeti ka përdorur lojë të bukur të fjalëve, artistikisht të stolisura me ngjyra estetike. Kjo e dëshmon përvojën e tij të gjatë në krijimtarinë letrare, e mbi të gjitha talentin e spikatur. Poezitë e tij i përgjigjen kërkesave letrare. Poeti në vargjet e këtij vëllimi ka shkrirë mall, vuajtje e pezëm, të mbështjella kujdesshëm me një veshje optimiste, duke përdorur elemente të shumta të natyrës në formë simbolesh e figuracionesh, si: dafina, lulja, luleshqerrat, selvia, plepishta, shelgu, mali, deti, lumi, dielli, zogjtë, lejleku, këndesi, stinët, galopi i

FLUTURAT E DJEGURA

VËSHTRIM PËR VËLLIMIN POETIK "FLUTURAT E DJEGURA" TË POETIT ADEM ZAPLLUZHA

Poeti Adem Zaplluzha është një emër i njohur në letërsinë shqipe. Ky krijues deri më tani ka botuar 163 libra me poezi. Poeti një pjesë të mirë të jetës shpirtin e tij ia ka dhënë poezisë. Adem Zaplluzha është kreator i vargjeve të lira me një pasqyrim të qartë. Poezitë e tij kanë një kompozicion me nivel të kënaqshëm të strukturimit dhe me figura mirë të modeluara. Poeti ka përdorur lojë të bukur të fjalëve, artistikisht të stolisura me ngjyra estetike. Kjo e dëshmon përvojën e tij të gjatë në krijimtarinë letrare, e mbi të gjitha talentin e spikatur. Poezitë e tij i përgjigjen kërkesave letrare. Poeti në vargjet e këtij vëllimi ka shkrirë mall, vuajtje e pezëm, të mbështjella kujdesshëm me një veshje optimiste, duke përdorur elemente të shumta të natyrës në formë simbolesh e figuracionesh, si: dafina, lulja, luleshqerrat, selvia, plepishta, shelgu, mali, deti, lumi, dielli, zogjtë, lejleku, këndesi, stinët, galopi i

5

kalit, fluturat e kaltra, fluturat e djegura, kaltërsia e qiellit, shelgu i pikëlluar, fusha e mëllenjave etj. Përmes tyre lexohet edhe shpirti i çiltër e mjedisor i autorit, dashuria e tij e madhe për natyrën. Pavarësisht se nëpër vargje vëren dridhje emocionesh, shkarkim të vrullshëm plot mall, vuajtje, pezëm, dashuri e nostalgji, në të gjitha rastet ka kontroll emocional duke qëndruar natyrshëm në kuadër të kornizave. Kjo reflekton pjekuri të krijuar nga përvoja jetësore e autorit. Karakteristikë e veçantë e poetit është se përmes vargjeve ka krijuar një kanal të përshtatshëm, tërheqës e të qartë të komunikimit me lexuesin. Autori të bënë ta duash atdheun pa asnjë kusht, ta shporrësh rrëmbyeshëm të keqen, ta dashurosh natyrën dhe të ndërtosh kështjella respekti, mbështetjeje e kujdesi për mërgimtarët. Një pjesë e mirë e vargjeve ngjethen nga epidemitë e kësaj kohe të shkaktuara nga “kuajt e egër”. Kështu i quan autori drejtuesit e shtetit, atë të cilët “shqiponjave” po ua vrasin shpresën. Shpeshherë në vargjet e

ADEM ZAPLLUZHA

kalit, fluturat e kaltra, fluturat e djegura, kaltërsia e qiellit, shelgu i pikëlluar, fusha e mëllenjave etj. Përmes tyre lexohet edhe shpirti i çiltër e mjedisor i autorit, dashuria e tij e madhe për natyrën. Pavarësisht se nëpër vargje vëren dridhje emocionesh, shkarkim të vrullshëm plot mall, vuajtje, pezëm, dashuri e nostalgji, në të gjitha rastet ka kontroll emocional duke qëndruar natyrshëm në kuadër të kornizave. Kjo reflekton pjekuri të krijuar nga përvoja jetësore e autorit. Karakteristikë e veçantë e poetit është se përmes vargjeve ka krijuar një kanal të përshtatshëm, tërheqës e të qartë të komunikimit me lexuesin. Autori të bënë ta duash atdheun pa asnjë kusht, ta shporrësh rrëmbyeshëm të keqen, ta dashurosh natyrën dhe të ndërtosh kështjella respekti, mbështetjeje e kujdesi për mërgimtarët. Një pjesë e mirë e vargjeve ngjethen nga epidemitë e kësaj kohe të shkaktuara nga “kuajt e egër”. Kështu i quan autori drejtuesit e shtetit, atë të cilët “shqiponjave” po ua vrasin shpresën. Shpeshherë në vargjet e

6

poetit Adem Zaplluzha has armaturë qëndrese, përmes simbolit të kurmit të drurit. Këto i lidh pastaj fort me simbolin rrënjë, duke shpërfaq qëndresën e tij të papërkulur, pavarësisht stuhive të kohës. Libri “Fluturat e djegura” është i përbërë prej tri cikleve, ku dominojnë poezitë lirike. Në vijim dëshiroj të shkoqis disa vargje që i konsiderova afërsisht si mostra reprezentative të librit.Autori zbraz shpirtin e tij të mbushur si një lëmsh i tkurrur nga zjarri i pezmit e mllefit, ndezur nga aktualiteti i dhimbshëm që e rrethon poetin bashkë me pjesëtarët e shoqërisë së tij me të cilët frymon në Tokën e Shqiponjave:

“Kur rastisem pa dashje
Mes trajtave të fjalëve
Një shtëllungë prej bryme
Ma zë frymëmarrjen”
Krijuesi shpërfaq zhgënjimin, pikërisht kur ai do dëshironte bashkë me popullin e tij të shijonte frytet e lirisë. “Kuaj të egër” i quan ata të cilët me veprime të ndotura po ecin udhëve të dezorientuara (traversat e kalbura)

FLUTURAT E DJEGURA

poetit Adem Zaplluzha has armaturë qëndrese, përmes simbolit të kurmit të drurit. Këto i lidh pastaj fort me simbolin rrënjë, duke shpërfaq qëndresën e tij të papërkulur, pavarësisht stuhive të kohës. Libri “Fluturat e djegura” është i përbërë prej tri cikleve, ku dominojnë poezitë lirike. Në vijim dëshiroj të shkoqis disa vargje që i konsiderova afërsisht si mostra reprezentative të librit.Autori zbraz shpirtin e tij të mbushur si një lëmsh i tkurrur nga zjarri i pezmit e mllefit, ndezur nga aktualiteti i dhimbshëm që e rrethon poetin bashkë me pjesëtarët e shoqërisë së tij me të cilët frymon në Tokën e Shqiponjave:

“Kur rastisem pa dashje
Mes trajtave të fjalëve
Një shtëllungë prej bryme
Ma zë frymëmarrjen”
Krijuesi shpërfaq zhgënjimin, pikërisht kur ai do dëshironte bashkë me popullin e tij të shijonte frytet e lirisë. “Kuaj të egër” i quan ata të cilët me veprime të ndotura po ecin udhëve të dezorientuara (traversat e kalbura)

7

drejt ferrit. “Kuajt e egër” po ia shkelin popullit shpresat e njoma duke ia gllabëruar ardhmërinë, si rezultat i lakmisë së pakontrolluar:

“Frynte një stuhi e çmendur
Nga të katër anët e dynjasë
Frynin erërat e liga
Një tren i zgjebosur si kali i egër
Vraponte mbi traversat e kalbura”

Jo vetëm se shpreh zhgënjim, por sakaq kalon edhe në dëshpërim. Sikur nuk e sheh askund lirinë, as shtetin e tij të cilin e ka menduar si një gjenerues që kultivon lumturi e mirëqenie. Jo të tillë, siç e quan autori, të mbetur si statujat antike:

“Nëpër skutat e harresës
Ti nuk ishe askund
Në asnjë tregim
Nuk i zgjove zogjtë
Mbete si statujat antike”

“Çfarë Poeti përmes metaforave shpreh zëshëm dëshpërimin e tij edhe për heshtjen e shoqërisë ndaj “kuajve të egër”:

mund të të them sonte

ADEM ZAPLLUZHA

drejt ferrit. “Kuajt e egër” po ia shkelin popullit shpresat e njoma duke ia gllabëruar ardhmërinë, si rezultat i lakmisë së pakontrolluar:

“Frynte një stuhi e çmendur
Nga të katër anët e dynjasë
Frynin erërat e liga
Një tren i zgjebosur si kali i egër
Vraponte mbi traversat e kalbura”

Jo vetëm se shpreh zhgënjim, por sakaq kalon edhe në dëshpërim. Sikur nuk e sheh askund lirinë, as shtetin e tij të cilin e ka menduar si një gjenerues që kultivon lumturi e mirëqenie. Jo të tillë, siç e quan autori, të mbetur si statujat antike:

“Nëpër skutat e harresës
Ti nuk ishe askund
Në asnjë tregim
Nuk i zgjove zogjtë
Mbete si statujat antike”

“Çfarë Poeti përmes metaforave shpreh zëshëm dëshpërimin e tij edhe për heshtjen e shoqërisë ndaj “kuajve të egër”:

mund të të them sonte

8

Kjo hije mortore
Po i shpalos të gjitha kujtimet
Arkivoli i heshtjes
Mbrëmë qante si çilimi”

“Kuajt e egër” tani më të kamufluar në këmisha të bardha i përshkruan artistikisht përmes elementeve figurative. Autori synon të prek në thelb neuronet e lexuesit, me mesazhin misionar për zgjim, vetëdijesim dhe veprim kundër të keqes:

“Një orë e vjetër në mur
Ma përkujton orën e prishur
Në stacionin e trenave
Itineraret ishin të çmendur
U shëmbëllenin këmishëve të bardha”
(f.)

Megjithatë, duke shtegtuar vargjeve të librit, lexuesi do të gjej frymën e rikthimit të fijeve optimiste. Përmes rrënjëve të traditës “bukë e krip” poeti shpreh gatishmërinë të pranoj “udhëtarët e vonuar” (deri më sot të heshtur) të marrin në dorë fatin e atdheut. Autori sigurisht e ka fjalën për individët meritor:

“Në këtë kopsht në asnjë stinë
Nuk mbyllen dritaret
Portat janë gjithmonë të hapura
Për udhëtarët e vonuar
Kurdoherë ka bukë e kripë”

FLUTURAT E DJEGURA

Kjo hije mortore
Po i shpalos të gjitha kujtimet
Arkivoli i heshtjes
Mbrëmë qante si çilimi”

“Kuajt e egër” tani më të kamufluar në këmisha të bardha i përshkruan artistikisht përmes elementeve figurative. Autori synon të prek në thelb neuronet e lexuesit, me mesazhin misionar për zgjim, vetëdijesim dhe veprim kundër të keqes:

“Një orë e vjetër në mur
Ma përkujton orën e prishur
Në stacionin e trenave
Itineraret ishin të çmendur
U shëmbëllenin këmishëve të bardha”
(f.)

Megjithatë, duke shtegtuar vargjeve të librit, lexuesi do të gjej frymën e rikthimit të fijeve optimiste. Përmes rrënjëve të traditës “bukë e krip” poeti shpreh gatishmërinë të pranoj “udhëtarët e vonuar” (deri më sot të heshtur) të marrin në dorë fatin e atdheut. Autori sigurisht e ka fjalën për individët meritor:

“Në këtë kopsht në asnjë stinë
Nuk mbyllen dritaret
Portat janë gjithmonë të hapura
Për udhëtarët e vonuar
Kurdoherë ka bukë e kripë”

9

Vargjet e mëposhtme reflektojnë energjinë e pashtershme dhe këmbëngulësinë e poetit për të vazhduar misionin e tij, pavarësisht sfidave e moshës që ka. Në këtë rast, çuditshëm, simboli "kali i egër" transformohet në element pozitiv, që luan rolin e shpirtit poetik të autorit: të qëndrueshëm, të fuqishëm, të papërkulur e të pavdekshëm për të mbërritur të pamundurën:

"Gjithkund ishe me mua
Më përcolle deri në vdekje
Por ja që
Varri nuk me pranoi atë ditë
Dheu më tha
Kemi kohë për ty, shkruaj poezi

Andaj kuajt e egër
Nuk dinë ta ndalin galopin
Vrapojnë si rruazat e kuqe
Nëpër gjakun tim
Vrapojnë luadheve të kositura
Për të mbërritur të pamundurën"

ADEM ZAPLLUZHA

Vargjet e mëposhtme reflektojnë energjinë e pashtershme dhe këmbëngulësinë e poetit për të vazhduar misionin e tij, pavarësisht sfidave e moshës që ka. Në këtë rast, çuditshëm, simboli "kali i egër" transformohet në element pozitiv, që luan rolin e shpirtit poetik të autorit: të qëndrueshëm, të fuqishëm, të papërkulur e të pavdekshëm për të mbërritur të pamundurën:

"Gjithkund ishe me mua
Më përcolle deri në vdekje
Por ja që
Varri nuk me pranoi atë ditë
Dheu më tha
Kemi kohë për ty, shkruaj poezi

Andaj kuajt e egër
Nuk dinë ta ndalin galopin
Vrapojnë si rruazat e kuqe
Nëpër gjakun tim
Vrapojnë luadheve të kositura
Për të mbërritur të pamundurën"

10

Poeti Adem Zaplluzha është një mjeshtër i rrallë i lirikave, të cilat i ka krehur për mrekulli:

“Shiko gishtat e tua të hollë
Sa janë të mëdha kur i prekin
Notat në pentagram
Prekin me afsh të nesërmen”

.....

“Nëse nuk këndon në gjuhën tënde
Ofendohen tingujt
Asnjë flutur e kaltër
Nuk ulet në telin e qemanes”

Poeti e dëshmon mjeshtërinë e rrallë edhe tek vargjet epike:

“Me shtatë plagë në shtat
I shëmbëlleje
Gjergjit tonë të madh
Flije në krevatin e drunjtë
Shtruar me fier para disa viteve
Vetëm gjëma e drurit të mykur
Dëgjohej nën plagët e pashëruara”

Artistët e vërtetë kanë një botë të pastër të shpirtit. Ata janë misionar të humanizmit e paqes. Vargjet e mëposhtme e dëshmojnë

FLUTURAT E DJEGURA

Poeti Adem Zaplluzha është një mjeshtër i rrallë i lirikave, të cilat i ka krehur për mrekulli:

“Shiko gishtat e tua të hollë
Sa janë të mëdha kur i prekin
Notat në pentagram
Prekin me afsh të nesërmen”

.....

“Nëse nuk këndon në gjuhën tënde
Ofendohen tingujt
Asnjë flutur e kaltër
Nuk ulet në telin e qemanes”

Poeti e dëshmon mjeshtërinë e rrallë edhe tek vargjet epike:

“Me shtatë plagë në shtat
I shëmbëlleje
Gjergjit tonë të madh
Flije në krevatin e drunjtë
Shtruar me fier para disa viteve
Vetëm gjëma e drurit të mykur
Dëgjohej nën plagët e pashëruara”

Artistët e vërtetë kanë një botë të pastër të shpirtit. Ata janë misionar të humanizmit e paqes. Vargjet e mëposhtme e dëshmojnë

11

padyshim rreshtimin e autorit në këtë karvan misionarësh
“Po të kisha mundësi
Do mbillja në shpirtrat e njerëzve
Nga një degë dafine
Dhe diellin në sy të secilit
Që t’u shëmbëllejnë luleve nëpër luadhe
.....
Po të kisha mundësi
Do krijoja një tjetër diell
Për njerëzimin të mos ketë dimër
Sa shumë e dua pranverën dhe fluturat
Kur çelin dashuri në majat e mjegullave”
Poeti zbraz mllefin e tij nga malli për djemtë e mërguar, njëri në Kanada, kurse tjetri në Angli. Autori mërgimtarët i quan “Flutura të djegura”. Edhe në këtë rast djegien e brendshme e flladit me “gjethe” natyre:
“Më duket se ishin çmendur
Kanatat e dritareve
Asnjë xham s’kishte mbetur
Në kornizat e kalbura
Vetëm era e mykur
I hapte dhe mbyllte dyert”

ADEM ZAPLLUZHA

padyshim rreshtimin e autorit në këtë karvan misionarësh
“Po të kisha mundësi
Do mbillja në shpirtrat e njerëzve
Nga një degë dafine
Dhe diellin në sy të secilit
Që t’u shëmbëllejnë luleve nëpër luadhe
.....
Po të kisha mundësi
Do krijoja një tjetër diell
Për njerëzimin të mos ketë dimër
Sa shumë e dua pranverën dhe fluturat
Kur çelin dashuri në majat e mjegullave”
Poeti zbraz mllefin e tij nga malli për djemtë e mërguar, njëri në Kanada, kurse tjetri në Angli. Autori mërgimtarët i quan “Flutura të djegura”. Edhe në këtë rast djegien e brendshme e flladit me “gjethe” natyre:
“Më duket se ishin çmendur
Kanatat e dritareve
Asnjë xham s’kishte mbetur
Në kornizat e kalbura
Vetëm era e mykur
I hapte dhe mbyllte dyert”

12

“Më thuaj si t’i thërras zogjtë
Të kthehen në atdhe
Kur largohen edhe shtërgjet e fundit
Kam mall për këtë dru
Të cilit asnjë det nuk ja shuan flakën”
“Për çdo ditë të Zotit
Sa herë që ndizen qirinjtë
Shoh kah po na largohen
Fluturat e djegura”
Poeti e përjeton rëndë gjendjen aktuale në shtetin e tij të ri. Këtë gjendje e konsideron plotësisht në kundërshtim me pritjet që i kishte. Gjendje e cila nuk e qon në vend amanetin e dëshmorëve. Ai zgjat gishtin tek drejtuesit e shtetit që po shkelin mbi gjakun e dëshmorëve:
“Me fytyra të lodhura
Trishtueshëm na shikojnë statujat”
“Ky shi i hidhur
Që po rigon sot me trishtim
Mbase qenka loti i të harruarve”
Sado që nëpër vargje ngrihen stërkala
dallgësh plot pezëm, për një çast poeti

FLUTURAT E DJEGURA

“Më thuaj si t’i thërras zogjtë
Të kthehen në atdhe
Kur largohen edhe shtërgjet e fundit
Kam mall për këtë dru
Të cilit asnjë det nuk ja shuan flakën”
“Për çdo ditë të Zotit
Sa herë që ndizen qirinjtë
Shoh kah po na largohen
Fluturat e djegura”
Poeti e përjeton rëndë gjendjen aktuale në shtetin e tij të ri. Këtë gjendje e konsideron plotësisht në kundërshtim me pritjet që i kishte. Gjendje e cila nuk e qon në vend amanetin e dëshmorëve. Ai zgjat gishtin tek drejtuesit e shtetit që po shkelin mbi gjakun e dëshmorëve:
“Me fytyra të lodhura
Trishtueshëm na shikojnë statujat”
“Ky shi i hidhur
Që po rigon sot me trishtim
Mbase qenka loti i të harruarve”
Sado që nëpër vargje ngrihen stërkala
dallgësh plot pezëm, për një çast poeti

13

zgjohet fuqishëm si një feniks dhe shpërthen me vrull optimist:
“Drita abdikoi si mbreti i çmendur
Nën pjergullën e kuqe
Nuk mejnë zërat asnjanëse të gjinkallave”
.....
“Nga taverna e vjetër nëpër ajrin e plasaritur
Si mbretëreshë zbret
Duhma e verës së kuqe
Stina sivjet ishte e begatë
Rrushit të Kosovës i grisej lëkura”
Autori ngrit zërin e neglizhencës së institucioneve në funksion të ruajtjes së mjedisit, duke lejuar tregtimin me gjëra të vjetra e të dëmshme për mjedisin. Përmes këtij veprimi po shkaktohen dëme në shëndetin njeriut:
“Goma të vjetra automjetesh
Dhe pedale biçikletash
Të rrinë para syve
Si epitafet e varreve të rrënuara”
“Shikoj një maskë të zezë
Pas së cilës
Zgërdheshet fytyra

ADEM ZAPLLUZHA

zgjohet fuqishëm si një feniks dhe shpërthen me vrull optimist:
“Drita abdikoi si mbreti i çmendur
Nën pjergullën e kuqe
Nuk mejnë zërat asnjanëse të gjinkallave”
.....
“Nga taverna e vjetër nëpër ajrin e plasaritur
Si mbretëreshë zbret
Duhma e verës së kuqe
Stina sivjet ishte e begatë
Rrushit të Kosovës i grisej lëkura”
Autori ngrit zërin e neglizhencës së institucioneve në funksion të ruajtjes së mjedisit, duke lejuar tregtimin me gjëra të vjetra e të dëmshme për mjedisin. Përmes këtij veprimi po shkaktohen dëme në shëndetin njeriut:
“Goma të vjetra automjetesh
Dhe pedale biçikletash
Të rrinë para syve
Si epitafet e varreve të rrënuara”
“Shikoj një maskë të zezë
Pas së cilës
Zgërdheshet fytyra

14

.....
Vetëm përmendoret e bronzta
I mbyllin sytë e metaltë
I mbyllin nga pamjet bizare”
“Kur të vdes vendosni hirin tim
Në ndonjë hinore prej argjile
Mos prekni asnjë pëllëmbë të kësaj toke
Për varrimin tim
Aq shumë janë gërryer këto male
Sa që nuk ka mbetur
As dy gishta vend për bozhuret”

Vargje që preokupojnë autorin të krijoj një lidhje të natyrshme të trashëgimisë kombëtare me ritmin e të sotmes:

“Kalatë e lashta mijëvjeçare
Përcjellin me krenari
Rrymimin e valëve
.....

Kurse në grykën e Këlcyrës

Ariu i murrmë
I Ballkanit kryeneç ia lëpinë
Plagët e pashëruara të atdheut”

FLUTURAT E DJEGURA

.....
Vetëm përmendoret e bronzta
I mbyllin sytë e metaltë
I mbyllin nga pamjet bizare”
“Kur të vdes vendosni hirin tim
Në ndonjë hinore prej argjile
Mos prekni asnjë pëllëmbë të kësaj toke
Për varrimin tim
Aq shumë janë gërryer këto male
Sa që nuk ka mbetur
As dy gishta vend për bozhuret”

Vargje që preokupojnë autorin të krijoj një lidhje të natyrshme të trashëgimisë kombëtare me ritmin e të sotmes:

“Kalatë e lashta mijëvjeçare
Përcjellin me krenari
Rrymimin e valëve
.....

Kurse në grykën e Këlcyrës

Ariu i murrmë
I Ballkanit kryeneç ia lëpinë
Plagët e pashëruara të atdheut”

15

Vargjet që i shkoqita më lart ishin vetëm një pjesë e këtij thesari kulturor.
Libri “Fluturat e djegura” është një vlerë e shtuar e letërsisë sonë bashkëkohore shqipe. Për fund, shfrytëzoj rastin ta uroj mikun tim, poetin Adem Zaplluzha për këtë libër të çmueshëm. Autorit mendjendritur e dorartë i dëshiroj jetë të gjatë, në bashkëjetesë të përhershme me pendë e me letër të bardhë.

Me respekt!
Azem Osmani
Master në Komunikim Masiv dhe Gazetari

Prishtinë, 24.05.2018

ADEM ZAPLLUZHA

Vargjet që i shkoqita më lart ishin vetëm një pjesë e këtij thesari kulturor.
Libri “Fluturat e djegura” është një vlerë e shtuar e letërsisë sonë bashkëkohore shqipe. Për fund, shfrytëzoj rastin ta uroj mikun tim, poetin Adem Zaplluzha për këtë libër të çmueshëm. Autorit mendjendritur e dorartë i dëshiroj jetë të gjatë, në bashkëjetesë të përhershme me pendë e me letër të bardhë.

Me respekt!
Azem Osmani
Master në Komunikim Masiv dhe Gazetari

Prishtinë, 24.05.2018

16

Cikli i parë
Mes trajtave të fjalëve

FLUTURAT E DJEGURA

Cikli i parë
Mes trajtave të fjalëve

17

ADEM ZAPLLUZHA

18

NGA NJË DEGË

Nuk jam çam
S’jam toskë
As gegë
Por shqiptar
I mbirë
Dhe i rritur
Në një degë

FLUTURAT E DJEGURA

NGA NJË DEGË

Nuk jam çam
S’jam toskë
As gegë
Por shqiptar
I mbirë
Dhe i rritur
Në një degë

VESA ÇDO MENATË

Nuk patën fat
Ta përjetojnë lirinë
Ishin bijtë e zogjve
Fluturuan përtej hapësirave

Me një trastë të grisur
Dhe një copë bukë misri
Për ta mposhtur robërinë
Dolën në mal

Njëqind vjet i kënduan
Psalmet pagane
S'deshën të besojnë asnjë perëndie
E vetmja perëndeshë ishte flutura e kaltër

Luadhet kurrë më nuk lotuan
Vesa çdo menatë
Këndonte në sqepat e zogjve
Që flinin pranë përmendoreve të bronzta

ADEM ZAPLLUZHA

VESA ÇDO MENATË

Nuk patën fat
Ta përjetojnë lirinë
Ishin bijtë e zogjve
Fluturuan përtej hapësirave

Me një trastë të grisur
Dhe një copë bukë misri
Për ta mposhtur robërinë
Dolën në mal

Njëqind vjet i kënduan
Psalmet pagane
S'deshën të besojnë asnjë perëndie
E vetmja perëndeshë ishte flutura e kaltër

Luadhet kurrë më nuk lotuan
Vesa çdo menatë
Këndonte në sqepat e zogjve
Që flinin pranë përmendoreve të bronzta

20

NGA SECILA FJALË

Të flesh në shtigjet e hijeve
E të zgjohesh të nesërmen
Si një shpend i kaltër
Njëqind psalme do i këndosh
Gjuhës tënde të lashtë

Asgjë nuk tingëllon
Më bukur se shqipja
Nga secila fjalë
Buron një rrëke dashurie
Burojnë yjet e panumërta të lumturisë

Të këndosh për atdheun
Në gjuhën tënde të bukur
Është një bekim hyjnor
Zogjtë e tërë dynjasë
Ulen te selvitë e lagjes e të bekojnë

FLUTURAT E DJEGURA

NGA SECILA FJALË

Të flesh në shtigjet e hijeve
E të zgjohesh të nesërmen
Si një shpend i kaltër
Njëqind psalme do i këndosh
Gjuhës tënde të lashtë

Asgjë nuk tingëllon
Më bukur se shqipja
Nga secila fjalë
Buron një rrëke dashurie
Burojnë yjet e panumërta të lumturisë

Të këndosh për atdheun
Në gjuhën tënde të bukur
Është një bekim hyjnor
Zogjtë e tërë dynjasë
Ulen te selvitë e lagjes e të bekojnë

21

TI NUK U DUKE ASKUND

Sa e sa herë
Kërkova në zërin tim
Emrin tënd
Ti nuk ishe askund
Përtej shtatë bjeshkëve
Ike me fluturat e fëmijërisë

Zbrita edhe në fund të ferrit
Mos vallë të të gjej
Nëpër skutat e harresës
Ti nuk ishe askund
Në asnjë tregim
Nuk i zgjove zogjtë
Mbete si statujat antike

Njëqind dimra kaluan këndej pari
Kur nuk u zgjua pranvera
Të prita edhe te guri i varrit
Ti nuk u duke askund
Ndoshta as që ishe në këtë botë
Kot të paskam kërkuar në kohë dhe hapësirë

ADEM ZAPLLUZHA

TI NUK U DUKE ASKUND

Sa e sa herë
Kërkova në zërin tim
Emrin tënd
Ti nuk ishe askund
Përtej shtatë bjeshkëve
Ike me fluturat e fëmijërisë

Zbrita edhe në fund të ferrit
Mos vallë të të gjej
Nëpër skutat e harresës
Ti nuk ishe askund
Në asnjë tregim
Nuk i zgjove zogjtë
Mbete si statujat antike

Njëqind dimra kaluan këndej pari
Kur nuk u zgjua pranvera
Të prita edhe te guri i varrit
Ti nuk u duke askund
Ndoshta as që ishe në këtë botë
Kot të paskam kërkuar në kohë dhe hapësirë

22

ISHA LIS PA GJETHE

Nuk di a thua vallë
Isha duke zbritur
Ose duke ikur nga qielli
Por gjithsesi
I ngjaja eklipsit të hijes

Disa vjet bredha
Prej një shtegu në tjetrin
Askund nuk i pashë mrizet
Delet përtypeshin si lopët
Nga fijet e dëborës pjalmonte drita

Nuk di sa kohë mu deshtë
T'i shëmbëllej rrapit
Në çdo kohë m'i shkulën rrënjët
Isha lis pa gjethe
Në degët e të cilit vajtonin qyqet

FLUTURAT E DJEGURA

ISHA LIS PA GJETHE

Nuk di a thua vallë
Isha duke zbritur
Ose duke ikur nga qielli
Por gjithsesi
I ngjaja eklipsit të hijes

Disa vjet bredha
Prej një shtegu në tjetrin
Askund nuk i pashë mrizet
Delet përtypeshin si lopët
Nga fijet e dëborës pjalmonte drita

Nuk di sa kohë mu deshtë
T'i shëmbëllej rrapit
Në çdo kohë m'i shkulën rrënjët
Isha lis pa gjethe
Në degët e të cilit vajtonin qyqet

23

MES TRAJTAVE TË FJALËVE

Kur rastisem pa dashje
Mes trajtave të fjalëve
Një shtëllungë prej bryme
Ma zë frymëmarrjen

Ti nuk je askund
As që ishe në gjeografinë time
U shëmbëlleje pemëve pa rrënjë
Ishe lakuriqe si fjala e gënjeshtarit

Nuk lashë vend pa të kërkuar
I shkela të gjitha shtigjet
Ti ishe pemë pa fryte
Në parzmën e lënduar të malit

Në degët e tua të thata
Vetëm kukuvajkat kënduan
Asnjeri nuk kuptoi asnjëherë
Formën elipsoide të fjalës

ADEM ZAPLLUZHA

MES TRAJTAVE TË FJALËVE

Kur rastisem pa dashje
Mes trajtave të fjalëve
Një shtëllungë prej bryme
Ma zë frymëmarrjen

Ti nuk je askund
As që ishe në gjeografinë time
U shëmbëlleje pemëve pa rrënjë
Ishe lakuriqe si fjala e gënjeshtarit

Nuk lashë vend pa të kërkuar
I shkela të gjitha shtigjet
Ti ishe pemë pa fryte
Në parzmën e lënduar të malit

Në degët e tua të thata
Vetëm kukuvajkat kënduan
Asnjeri nuk kuptoi asnjëherë
Formën elipsoide të fjalës

24

MË KUJTOHEN ÇASTET E DEHJES

Kur nata vuante nga vetmia
Në dritaren tënde pa xhama
Në një copë gazete të grisur
Trokitën pemët e kopshtit të harruar
Trokitën
Nuk pushuan Deri sa të reshurat

Më kujtohen çastet e dehjes
Mbusheshin çafkat me pikëllim
Kafeneja dukej si një hambar
Ku pa asnjë frikë nga njeriu
Këndonin minjtë e dehur

Sonte secili njeri këndonte
Në mënyrën e vet të çmendur
Këndonin edhe tavolinat
Ajri i tymosur nga dehja
Rrinte këmbëkryq te oxhaku

Nuk pata më forcë
Të dëgjoj atë kakofoni
Monotone të degëve
I zgjova të gjitha pemët
Le të këndojnë deri në mëngjes
Psalmet e dehura të së dielës

FLUTURAT E DJEGURA

MË KUJTOHEN ÇASTET E DEHJES

Kur nata vuante nga vetmia
Në dritaren tënde pa xhama
Në një copë gazete të grisur
Trokitën pemët e kopshtit të harruar
Trokitën
Nuk pushuan Deri sa të reshurat

Më kujtohen çastet e dehjes
Mbusheshin çafkat me pikëllim
Kafeneja dukej si një hambar
Ku pa asnjë frikë nga njeriu
Këndonin minjtë e dehur

Sonte secili njeri këndonte
Në mënyrën e vet të çmendur
Këndonin edhe tavolinat
Ajri i tymosur nga dehja
Rrinte këmbëkryq te oxhaku

Nuk pata më forcë
Të dëgjoj atë kakofoni
Monotone të degëve
I zgjova të gjitha pemët
Le të këndojnë deri në mëngjes
Psalmet e dehura të së dielës

25

ARKIVOLI I HESHTJES

Çfarë mund të të them sonte
Kjo hije mortore
Po i shpalos të gjitha kujtimet
Arkivoli i heshtjes
Mbrëmë qante si çilimi

Unë nuk dua të vdes
Le të vdesin shpirtrat e ligë
Kjo natë i paska të gjitha dhembjet
Nëpër dhomat e spitalit
Vallëzojnë kufomat e dyllta

Një orë e vjetër në mur
Ma përkujton orën e prishur
Në stacionin e trenave
Itineraret ishin të çmendur
U shëmbëllenin këmishëve të bardha

Mbrëmë pash një anije fantazmë
E cila kishte mbetur pa vela
Dukej si një skelet njeriu
Dukej si ashti i thyer
I një historie lavire

ADEM ZAPLLUZHA

ARKIVOLI I HESHTJES

Çfarë mund të të them sonte
Kjo hije mortore
Po i shpalos të gjitha kujtimet
Arkivoli i heshtjes
Mbrëmë qante si çilimi

Unë nuk dua të vdes
Le të vdesin shpirtrat e ligë
Kjo natë i paska të gjitha dhembjet
Nëpër dhomat e spitalit
Vallëzojnë kufomat e dyllta

Një orë e vjetër në mur
Ma përkujton orën e prishur
Në stacionin e trenave
Itineraret ishin të çmendur
U shëmbëllenin këmishëve të bardha

Mbrëmë pash një anije fantazmë
E cila kishte mbetur pa vela
Dukej si një skelet njeriu
Dukej si ashti i thyer
I një historie lavire

26

QËNDRONIM SI STIVAT E DRURËVE

Nëpër akaciet e fshatit
Qanin zogjtë shurdhmemec
Asnjë kambanë nuk dëgjuam mbrëmë
Thua se
Kishin vdekur të gjitha meshat

Një ikonë e vjetër qëndronte
Varur në murin e kujtesës
Qëndronte dhe qante si fëmijë
Askush nga të pranishmit
Nuk ia prekte lotin e hidhur

Ne ishim të stepur
Qëndronim si stivat e drurëve
Kur deshëm të qajmë
Me një qull kuajsh
Na e mbyllën sytë dhe gojën

Imituam kukuvajkën
Në shpirtin tonë dëneste nata
Mbase ishte hera e parë
Kur pamë
Se si lahen duart e ndërgjegjes

FLUTURAT E DJEGURA

QËNDRONIM SI STIVAT E DRURËVE

Nëpër akaciet e fshatit
Qanin zogjtë shurdhmemec
Asnjë kambanë nuk dëgjuam mbrëmë
Thua se
Kishin vdekur të gjitha meshat

Një ikonë e vjetër qëndronte
Varur në murin e kujtesës
Qëndronte dhe qante si fëmijë
Askush nga të pranishmit
Nuk ia prekte lotin e hidhur

Ne ishim të stepur
Qëndronim si stivat e drurëve
Kur deshëm të qajmë
Me një qull kuajsh
Na e mbyllën sytë dhe gojën

Imituam kukuvajkën
Në shpirtin tonë dëneste nata
Mbase ishte hera e parë
Kur pamë
Se si lahen duart e ndërgjegjes

27

HESHTJA ËSHTË PËRGJIGJA MË E MIRË

Nuk ka më trishtim
Kur mëson njeriu
Se heshtja është përgjigje

Secila fjalë që lind më vonë
E ka formën e vdekjes
Andaj edhe gurëzohen nofullat

Sa herë që i pyesim kalimtarët
Për formën e fjalëve
Heshtja është përgjigja më e mirë

Kur mëson njeriu se heshtja
Nuk vdes asnjëherë
Atë çast belbëzon si druri i mykur

ADEM ZAPLLUZHA

HESHTJA ËSHTË PËRGJIGJA MË E MIRË

Nuk ka më trishtim
Kur mëson njeriu
Se heshtja është përgjigje

Secila fjalë që lind më vonë
E ka formën e vdekjes
Andaj edhe gurëzohen nofullat

Sa herë që i pyesim kalimtarët
Për formën e fjalëve
Heshtja është përgjigja më e mirë

Kur mëson njeriu se heshtja
Nuk vdes asnjëherë
Atë çast belbëzon si druri i mykur

28

NË KOPSHT

Kur qajnë pemët
Nën rrënjët e kujtesës
Lindin tregimet fantazmagorike
Lindin nga një vdekje
E cila kurrë nuk ka ekzistuar

Në kopsht dhe nëpër pragje
Parakalojnë portat e rënda
Nga dritaret e errësuara
Duart prej rëre
I përshëndesin udhëtarët e vonuar

Askush nuk troket
Në dyert e mbyllura të kopshtit
Vetëm pemët qëndrojnë të gatshme
T'i kafshojnë pëllumbat e egër
Në që se fluturojnë pa ftesë

Në këtë kopsht në asnjë stinë
Nuk mbyllen dritaret
Portat janë gjithmonë të hapura
Për udhëtarët e vonuar
Kurdoherë ka bukë e kripë

Prishtinë, 8 prill 2018

FLUTURAT E DJEGURA

NË KOPSHT

Kur qajnë pemët
Nën rrënjët e kujtesës
Lindin tregimet fantazmagorike
Lindin nga një vdekje
E cila kurrë nuk ka ekzistuar

Në kopsht dhe nëpër pragje
Parakalojnë portat e rënda
Nga dritaret e errësuara
Duart prej rëre
I përshëndesin udhëtarët e vonuar

Askush nuk troket
Në dyert e mbyllura të kopshtit
Vetëm pemët qëndrojnë të gatshme
T'i kafshojnë pëllumbat e egër
Në që se fluturojnë pa ftesë

Në këtë kopsht në asnjë stinë
Nuk mbyllen dritaret
Portat janë gjithmonë të hapura
Për udhëtarët e vonuar
Kurdoherë ka bukë e kripë

Prishtinë, 8 prill 2018

29

SI LOPËT E DIELLIT PALLTE HËNA

Nuk di nga cila anë
Por mbrëmë frynte një stuhi e çmendur
Frynte nëpër damarët e lisit
Mallkimi i një shekulli

Ikën edhe zogjtë nga kujtesa
Asgjë nuk më mbeti
Vetëm harresa po lëron
Nëpër rrashtën time të thyer

Pyeta me rrallë udhëtarët e vonuar
Pyeta për ardhjen
Ose ikjen tënde misterioze
Asnjë fjalë nga lisat e kalbur

Hyra mes algave të murrme
Dëgjova vigmën e një lope
Nuk mente as Lumëbardhi
Si lopët e diellit pallte hëna

ADEM ZAPLLUZHA

SI LOPËT E DIELLIT PALLTE HËNA

Nuk di nga cila anë
Por mbrëmë frynte një stuhi e çmendur
Frynte nëpër damarët e lisit
Mallkimi i një shekulli

Ikën edhe zogjtë nga kujtesa
Asgjë nuk më mbeti
Vetëm harresa po lëron
Nëpër rrashtën time të thyer

Pyeta me rrallë udhëtarët e vonuar
Pyeta për ardhjen
Ose ikjen tënde misterioze
Asnjë fjalë nga lisat e kalbur

Hyra mes algave të murrme
Dëgjova vigmën e një lope
Nuk mente as Lumëbardhi
Si lopët e diellit pallte hëna

30

ME KËTË KOPE PA TË ZOT

Kush po fërshëllen kaq vonë
Ndoshta trishtimit i ka ikur gjumi
Një zog rebel
Me një këmbë të thyer
Qëndronte mbi telat elektrike

Frynte një stuhi e çmendur
Nga të katër anët e dynjasë
Frynin erërat e liga
Një tren i zgjebosur si kali i egër
Vraponte mbi traversat e kalbura

Asnjë zog nuk fluturoi atë natë
Çerdhet lëshuan rrënjë
Mbi plagët e lisave
Atdheu i shëmbëllente si kurrë më parë
Lëkurës së grisur të leopardit

Ne nuk kishim një tjetër atdhe
Ku të shkojmë sonte
Me këta njerëz pa të zot
Nata e egër mbi një oltar të dyshimtë
Abortoi për të shtatën herë

FLUTURAT E DJEGURA

ME KËTË KOPE PA TË ZOT

Kush po fërshëllen kaq vonë
Ndoshta trishtimit i ka ikur gjumi
Një zog rebel
Me një këmbë të thyer
Qëndronte mbi telat elektrike

Frynte një stuhi e çmendur
Nga të katër anët e dynjasë
Frynin erërat e liga
Një tren i zgjebosur si kali i egër
Vraponte mbi traversat e kalbura

Asnjë zog nuk fluturoi atë natë
Çerdhet lëshuan rrënjë
Mbi plagët e lisave
Atdheu i shëmbëllente si kurrë më parë
Lëkurës së grisur të leopardit

Ne nuk kishim një tjetër atdhe
Ku të shkojmë sonte
Me këta njerëz pa të zot
Nata e egër mbi një oltar të dyshimtë
Abortoi për të shtatën herë

31

PËR TË MBËRRITUR TË PAMUNDURËN

Si një kalë i egër
Me griva të thyera
Kalërove nëpër shpirtin tim
Ti vargu im i çmendur
Nuk pat zinxhir dot
Që mund ta ngufate frymën tënde

Gjithkund ishe me mua
Më përcolle deri në vdekje
Por ja që
Varri nuk me pranoi atë ditë
Dheu me tha
Kemi kohë për ty shkruaj poezi

Andaj kuajt e egër
Nuk dinë ta ndalin galopin
Vrapojnë si rruazat e kuqe
Nëpër gjakun tim
Vrapojnë luadheve të kositura
Për të mbërritur të pamundurën

ADEM ZAPLLUZHA

PËR TË MBËRRITUR TË PAMUNDURËN

Si një kalë i egër
Me griva të thyera
Kalërove nëpër shpirtin tim
Ti vargu im i çmendur
Nuk pat zinxhir dot
Që mund ta ngufate frymën tënde

Gjithkund ishe me mua
Më përcolle deri në vdekje
Por ja që
Varri nuk me pranoi atë ditë
Dheu me tha
Kemi kohë për ty shkruaj poezi

Andaj kuajt e egër
Nuk dinë ta ndalin galopin
Vrapojnë si rruazat e kuqe
Nëpër gjakun tim
Vrapojnë luadheve të kositura
Për të mbërritur të pamundurën

32

TI PËRGATITESHE QË SËRISH TË NISESH

Sa herë që u ktheve
I lodhur
Dhe i dërmuar nga luftërat
Askush nuk të priti me lule
Ishte një përbuzje tinëzare
Ua prishje rehatinë
Në dyshekun e mbushur me pupla

Me shtatë plagë në shtat
I shëmbëlleje
Gjergjit tonë të madh
Flije në krevatin e drunjtë
Shtruar me fier para disa viteve
Vetëm gjëma e drurit të mykur
Dëgjohej nën plagët e pashëruara

Atdheu të rrinte mbi kokë
Dhe qante si kalama
Kur plagët kullonin dhembje
Dhe dëshpërim
Ti përgatiteshe që sërish të nisesh
Në luftën tënde të papërfunduar
Sepse pas maleve veç ishin nisur ujqërit

FLUTURAT E DJEGURA

TI PËRGATITESHE QË SËRISH TË NISESH

Sa herë që u ktheve
I lodhur
Dhe i dërmuar nga luftërat
Askush nuk të priti me lule
Ishte një përbuzje tinëzare
Ua prishje rehatinë
Në dyshekun e mbushur me pupla

Me shtatë plagë në shtat
I shëmbëlleje
Gjergjit tonë të madh
Flije në krevatin e drunjtë
Shtruar me fier para disa viteve
Vetëm gjëma e drurit të mykur
Dëgjohej nën plagët e pashëruara

Atdheu të rrinte mbi kokë
Dhe qante si kalama
Kur plagët kullonin dhembje
Dhe dëshpërim
Ti përgatiteshe që sërish të nisesh
Në luftën tënde të papërfunduar
Sepse pas maleve veç ishin nisur ujqërit

33

NUK ULET NË TELIN E QEMANES

Nuk të duhet shumë
Për t'i mbushur tetë vjet
Pyete violinën
Ku e ka fshehur zërin për ty

E di si do të këndosh nesër
Kur qemania
I mbush tetëdhjetë e tetë vjet
Në ledhet e historisë e kërkon gjenezën

Shiko gishtat e tua të hollë
Sa janë të mëdha kur i prekin
Notat në pentagram
Prekin me afsh të nesërmen

Më beso ishe ti që zgjove
Te unë poetin e fjetur
E zgjove të kaluarën
Dhe të ardhmen e tingujve

Nëse nuk këndon në gjuhën tënde
Ofendohen tingujt
Asnjë flutur e kaltër
Nuk ulet në telin e qemanes

ADEM ZAPLLUZHA

NUK ULET NË TELIN E QEMANES

Nuk të duhet shumë
Për t'i mbushur tetë vjet
Pyete violinën
Ku e ka fshehur zërin për ty

E di si do të këndosh nesër
Kur qemania
I mbush tetëdhjetë e tetë vjet
Në ledhet e historisë e kërkon gjenezën

Shiko gishtat e tua të hollë
Sa janë të mëdha kur i prekin
Notat në pentagram
Prekin me afsh të nesërmen

Më beso ishe ti që zgjove
Te unë poetin e fjetur
E zgjove të kaluarën
Dhe të ardhmen e tingujve

Nëse nuk këndon në gjuhën tënde
Ofendohen tingujt
Asnjë flutur e kaltër
Nuk ulet në telin e qemanes

34

TI ISHE NJË NJERI PA IDENTITET

Të kam fshehur
Brenda kësaj kartoline
Më kujtohet kur ishe flutur
Qielli i përkite vendlindjes tënde

Sa herë të pyeta për ekuinoksin
Ti nuk kishe asnjë përgjigje
Të dukej vetja
Si një anije fantazmë

Të shikoja se si ikje me pranverën
Në ty jetonte dimri
Netët e sterrët ishin pa asnjë qiri
Vetëm yjet e kyçura bënin dritë

Dikur vonë kur të zuri mosha peng
E fute kartolinën në arkën postare
E cila kurrë nuk e gjeti adresën
Ti ishe një njeri pa identitet

FLUTURAT E DJEGURA

TI ISHE NJË NJERI PA IDENTITET

Të kam fshehur
Brenda kësaj kartoline
Më kujtohet kur ishe flutur
Qielli i përkite vendlindjes tënde

Sa herë të pyeta për ekuinoksin
Ti nuk kishe asnjë përgjigje
Të dukej vetja
Si një anije fantazmë

Të shikoja se si ikje me pranverën
Në ty jetonte dimri
Netët e sterrët ishin pa asnjë qiri
Vetëm yjet e kyçura bënin dritë

Dikur vonë kur të zuri mosha peng
E fute kartolinën në arkën postare
E cila kurrë nuk e gjeti adresën
Ti ishe një njeri pa identitet

35

ÇFARË T'U THEM FLUTURAVE

Ike si një fantazmë
Thellësive tinëzare të detit të trazuar
Nuk u ndale as në ëndrrën time
A mund të përgjigjem fluturave
Që presin te majat e lisave

Më duket se të kota janë lutjet e mia
Eja një natë në ëndrrën time
Eja me të gjitha të ligat e tua
Asnjëherë nuk më zgjove nga gjumi
Kur i shuaja etjet e kuajve

Ti sërish del e rri në errësirë
I shkyç të gjitha yjet
Parapëlqen sterrën
Ndoshta i imiton vampirët
Sa shumë i shëmbëllen djallit të zi

ADEM ZAPLLUZHA

ÇFARË T'U THEM FLUTURAVE

Ike si një fantazmë
Thellësive tinëzare të detit të trazuar
Nuk u ndale as në ëndrrën time
A mund të përgjigjem fluturave
Që presin te majat e lisave

Më duket se të kota janë lutjet e mia
Eja një natë në ëndrrën time
Eja me të gjitha të ligat e tua
Asnjëherë nuk më zgjove nga gjumi
Kur i shuaja etjet e kuajve

Ti sërish del e rri në errësirë
I shkyç të gjitha yjet
Parapëlqen sterrën
Ndoshta i imiton vampirët
Sa shumë i shëmbëllen djallit të zi

36

I PËSHTYNË XHAMAT E DRITAREVE

Shiu tinëzar troket
Nëpër xhamat e palara
Troket si korbi i moshuar
Brenda nga dhoma e boshatisur
Paskan pushuar zërat e ëndrrave

Era si e babëzitur fryn nga të katër anët
I pështynë xhamat e dritareve
Që nuk janë hapur me shekuj
Një njeri si i huaj
Qëndron në shtëpinë e vet

Sërish nuk prajnë krakëllimat e korbave
Të lehurat nëpër rrugë
I prekin telat e ndryshkur të monotonisë
Një hije e murrme
Me tërë peshën e zisë zbret nga malet

FLUTURAT E DJEGURA

I PËSHTYNË XHAMAT E DRITAREVE

Shiu tinëzar troket
Nëpër xhamat e palara
Troket si korbi i moshuar
Brenda nga dhoma e boshatisur
Paskan pushuar zërat e ëndrrave

Era si e babëzitur fryn nga të katër anët
I pështynë xhamat e dritareve
Që nuk janë hapur me shekuj
Një njeri si i huaj
Qëndron në shtëpinë e vet

Sërish nuk prajnë krakëllimat e korbave
Të lehurat nëpër rrugë
I prekin telat e ndryshkur të monotonisë
Një hije e murrme
Me tërë peshën e zisë zbret nga malet

37

Shiu troket e troket nëpër qepena
Kalldrëmet e lashta ilire
I hapin portat e rënda të kalave
Nga muret e larta të kujtesës
Fluturojnë hapësirave dykrenorët e gdhendur

ADEM ZAPLLUZHA

Shiu troket e troket nëpër qepena
Kalldrëmet e lashta ilire
I hapin portat e rënda të kalave
Nga muret e larta të kujtesës
Fluturojnë hapësirave dykrenorët e gdhendur

PA NJË DEGË DAFINE

Ka kohë që ndjente një lodhje
Ishte i vetmi njeri
Që shumë pak kërkonte
Prej të tjerëve
Veç pak diell mbi kokë
E trastën e mbushur me bukë

Sa herë që u pamë
Mes degëve të gështenjave
Shikonte diellin
Mbase nuk kishte nevojë për asgjë
Kur i hynte në shpirt
Liria alegorike e të robëruarve

Kurrë nuk dilte në qytet
Pa një degë dafine
Ah liria e anatemuar
Sa kishte etje
Po aq edhe uri për të jetuar si një zog
Miku im me mendime alegorike

FLUTURAT E DJEGURA

PA NJË DEGË DAFINE

Ka kohë që ndjente një lodhje
Ishte i vetmi njeri
Që shumë pak kërkonte
Prej të tjerëve
Veç pak diell mbi kokë
E trastën e mbushur me bukë

Sa herë që u pamë
Mes degëve të gështenjave
Shikonte diellin
Mbase nuk kishte nevojë për asgjë
Kur i hynte në shpirt
Liria alegorike e të robëruarve

Kurrë nuk dilte në qytet
Pa një degë dafine
Ah liria e anatemuar
Sa kishte etje
Po aq edhe uri për të jetuar si një zog
Miku im me mendime alegorike

39

PO TË KISHA MUNDËSI

Po të kisha mundësi
Do mbillja në shpirtrat e njerëzve
Nga një degë dafine
Dhe diellin në sy të secilit
Që t'u shëmbëllejnë luleve nëpër luadhe

Do bëhesha lumë në galopin
E urrejtjes
T'i laj të gjitha të ligat
Që lindin nëpër shpirtrat e këqij
Të mos ketë më luftë shfarosëse në botë

Po të kisha mundësi
Do krijoja një tjetër diell
Për njerëzimin të mos ketë dimër
Sa shumë e dua pranverën dhe fluturat
Kur çelin dashuri në majat e mjegullave

ADEM ZAPLLUZHA

PO TË KISHA MUNDËSI

Po të kisha mundësi
Do mbillja në shpirtrat e njerëzve
Nga një degë dafine
Dhe diellin në sy të secilit
Që t'u shëmbëllejnë luleve nëpër luadhe

Do bëhesha lumë në galopin
E urrejtjes
T'i laj të gjitha të ligat
Që lindin nëpër shpirtrat e këqij
Të mos ketë më luftë shfarosëse në botë

Po të kisha mundësi
Do krijoja një tjetër diell
Për njerëzimin të mos ketë dimër
Sa shumë e dua pranverën dhe fluturat
Kur çelin dashuri në majat e mjegullave

40

UNË NUK ISHA ODISEJA

Unë kurrë nuk isha Odiseja
As ti Itaka
Nuk arriti asnjë zarf i kaltër
Në çastin kur u shemb dynjaja
Mbi rrashtën time
I dëgjova të lehurat e hënës

Unë nuk i shëmbëlleja
As hijes tënde
Por edhe ti nuk ishe Penelopa
Ishe grua e zbrazët
Si rropullitë e erës
Një gjemb i thyer trëndafili

Degë e këputur ulliri
Ishe kujë në gjëmën e Jonit
Zë i trishtuar i ndërgjegjes
Unë nuk isha Odiseja
Nuk më njohu as qeni im
Por lehja e hënës kurrë nuk pushoi

FLUTURAT E DJEGURA

UNË NUK ISHA ODISEJA

Unë kurrë nuk isha Odiseja
As ti Itaka
Nuk arriti asnjë zarf i kaltër
Në çastin kur u shemb dynjaja
Mbi rrashtën time
I dëgjova të lehurat e hënës

Unë nuk i shëmbëlleja
As hijes tënde
Por edhe ti nuk ishe Penelopa
Ishe grua e zbrazët
Si rropullitë e erës
Një gjemb i thyer trëndafili

Degë e këputur ulliri
Ishe kujë në gjëmën e Jonit
Zë i trishtuar i ndërgjegjes
Unë nuk isha Odiseja
Nuk më njohu as qeni im
Por lehja e hënës kurrë nuk pushoi

41

DY VARKA TË MBËSHTETURA

Në një kornizë të dylltë
Mbi një kanavacë të vjetër
Vendosa një flutur
Një portret surrealist
Buzëqeshte tmerrësisht buzëqeshte
Në thellësinë e pasqyrës

Disa dete të shthurura
Dallgëzonin si marinarët e dehur
Nata me një çafkë raki
Ngrite dolli
Me yjet klandestin
Ngrite çafkën në emër të dashurisë

Dy varka të mbështetura
Për trupin e anijes
Dukeshin nga kjo perspektivë
Si dy dete të dehura
Për sonte më mjaftuan
Dy gllënjka raki nga çafkat e dehura

ADEM ZAPLLUZHA

DY VARKA TË MBËSHTETURA

Në një kornizë të dylltë
Mbi një kanavacë të vjetër
Vendosa një flutur
Një portret surrealist
Buzëqeshte tmerrësisht buzëqeshte
Në thellësinë e pasqyrës

Disa dete të shthurura
Dallgëzonin si marinarët e dehur
Nata me një çafkë raki
Ngrite dolli
Me yjet klandestin
Ngrite çafkën në emër të dashurisë

Dy varka të mbështetura
Për trupin e anijes
Dukeshin nga kjo perspektivë
Si dy dete të dehura
Për sonte më mjaftuan
Dy gllënjka raki nga çafkat e dehura

42

KRIPA E ETUR I NJOMTE BUZËT

Një pulëbardhë me një gjethe dafine
Në sqep
U ankorua në mol
Fanari i kishte shkyçur dritat
Ara lozte një tango të lashtë në shi

Nëpër skuta vallëzonin
Tasat e konservave
Peshqit e ngordhur herë i hapnin
E herë i mbyllin sytë
Fanari shikonte me habi këtë teatër modern

Kripa e etur i njomte buzët
E trëndafilit të zi
Në molin ku vallëzonin konservat në shi
Një dritë si nga llambadarët
Herë kyçej e herë shkyçej në errësirë

FLUTURAT E DJEGURA

KRIPA E ETUR I NJOMTE BUZËT

Një pulëbardhë me një gjethe dafine
Në sqep
U ankorua në mol
Fanari i kishte shkyçur dritat
Ara lozte një tango të lashtë në shi

Nëpër skuta vallëzonin
Tasat e konservave
Peshqit e ngordhur herë i hapnin
E herë i mbyllin sytë
Fanari shikonte me habi këtë teatër modern

Kripa e etur i njomte buzët
E trëndafilit të zi
Në molin ku vallëzonin konservat në shi
Një dritë si nga llambadarët
Herë kyçej e herë shkyçej në errësirë

43

PËR MREKULLI KËNDONIN PUSHKËT

Pohuan se kishte ndodhur
Një masakër
Britmat u dëgjuan edhe në qytet
Ishin mbushur valixhet
Me gjymtyrë fëmijësh

Nënat me flokë të shkulura
Ngjanin me erën çmendur
Piskamat heshtën
Mbase nuk kishin më forcë për britma
Një qetësi mortore e mbuloi Prekazin

Rra i tërë fshati në dy gjunjë
Zia pllakosi si heshtja
Rranë edhe fshatra të tjerë
Por Kosova
Qëndronte si kala e pamposhtur

U shembën udhët malet
Lisat një kohë të gjatë
Ishin të përmbysur
Por nëpër istikame
Për mrekulli këndonin pushkët

ADEM ZAPLLUZHA

PËR MREKULLI KËNDONIN PUSHKËT

Pohuan se kishte ndodhur
Një masakër
Britmat u dëgjuan edhe në qytet
Ishin mbushur valixhet
Me gjymtyrë fëmijësh

Nënat me flokë të shkulura
Ngjanin me erën çmendur
Piskamat heshtën
Mbase nuk kishin më forcë për britma
Një qetësi mortore e mbuloi Prekazin

Rra i tërë fshati në dy gjunjë
Zia pllakosi si heshtja
Rranë edhe fshatra të tjerë
Por Kosova
Qëndronte si kala e pamposhtur

U shembën udhët malet
Lisat një kohë të gjatë
Ishin të përmbysur
Por nëpër istikame
Për mrekulli këndonin pushkët

44

MBASE VARRI I GJYSHIT TIM KRENAR

Kur u kthyet të lodhur nga luftërat
Pragjet e dyerve
Dukeshin të përtypura nga koha
Në një valixhe të vjetër
Mund të futeshin të gjitha kornizat

Asnjë njeri nëpër shtëpi
Vetëm macet e egra gjuanin minjtë
S'dëgjohen as të lehurat
Ka kohë që kanë vdekur oxhaqet
Asnjë vij tymi s'duket mbi çati

Një zë si nga lashtësia
Ose nga honi i pafund dëgjohet
Në kopshtin e mbuluar me baroja
Mbase varri i gjyshit tim krenar
Për herë të fundit proteston

FLUTURAT E DJEGURA

MBASE VARRI I GJYSHIT TIM KRENAR

Kur u kthyet të lodhur nga luftërat
Pragjet e dyerve
Dukeshin të përtypura nga koha
Në një valixhe të vjetër
Mund të futeshin të gjitha kornizat

Asnjë njeri nëpër shtëpi
Vetëm macet e egra gjuanin minjtë
S'dëgjohen as të lehurat
Ka kohë që kanë vdekur oxhaqet
Asnjë vij tymi s'duket mbi çati

Një zë si nga lashtësia
Ose nga honi i pafund dëgjohet
Në kopshtin e mbuluar me baroja
Mbase varri i gjyshit tim krenar
Për herë të fundit proteston

45

NË SYTË E VERBËR TË VARRIT QAJNË DY KORBA

Këtu s’qenka fundi
As fillimi i betejës
Mes flamujve të grisur
Dhe ngordhësirave
Qenka ndalur frymëmarrja

Një tufë zogjsh pa sqep
Dhe me pendla të ndukura
Zbresin nga një çati
Për ta shuar etjen
Zbresin nga arena e vdekjes fluturat

Asnjë njeri përreth istikameve
Ka kohë që në këtë fushëbetejë
Nuk dëgjohen hingëllimat
Paskan vdekur edhe mëgojëzat
Në sytë e verbër të varrit qajnë dy korba

Prishtinë, 9 prill 2018

ADEM ZAPLLUZHA

NË SYTË E VERBËR TË VARRIT QAJNË DY KORBA

Këtu s’qenka fundi
As fillimi i betejës
Mes flamujve të grisur
Dhe ngordhësirave
Qenka ndalur frymëmarrja

Një tufë zogjsh pa sqep
Dhe me pendla të ndukura
Zbresin nga një çati
Për ta shuar etjen
Zbresin nga arena e vdekjes fluturat

Asnjë njeri përreth istikameve
Ka kohë që në këtë fushëbetejë
Nuk dëgjohen hingëllimat
Paskan vdekur edhe mëgojëzat
Në sytë e verbër të varrit qajnë dy korba

Prishtinë, 9 prill 2018

46

Cikli i dytë
Fluturat e djegura

FLUTURAT E DJEGURA

Cikli i dytë
Fluturat e djegura

47

ADEM ZAPLLUZHA

48

GJELBËRIMI NGRIT KOKËN

Mes petaleve të kuqërremta
Puthi gjembat e tua
Nga rrënjët buron aroma e avullit
Një gjinkallë
Natë e ditë këndon për dashurinë

Gjelbërimi ngrit kokën
Shikon se si avullon frymëmarrja
Një milingonë e verdhë
Me thasët e ngarkuar të përditshmërisë
Kalon tej rrugës së stacionit

Hamajtë ecin duke u tulatur
Nën peshën e barrës së rëndë
Kurse milingona shtatëqind herë më e vogël
Zgërdheshet me ironi
Me njerëzit që lahen nën djersët e ditës

FLUTURAT E DJEGURA

GJELBËRIMI NGRIT KOKËN

Mes petaleve të kuqërremta
Puthi gjembat e tua
Nga rrënjët buron aroma e avullit
Një gjinkallë
Natë e ditë këndon për dashurinë

Gjelbërimi ngrit kokën
Shikon se si avullon frymëmarrja
Një milingonë e verdhë
Me thasët e ngarkuar të përditshmërisë
Kalon tej rrugës së stacionit

Hamajtë ecin duke u tulatur
Nën peshën e barrës së rëndë
Kurse milingona shtatëqind herë më e vogël
Zgërdheshet me ironi
Me njerëzit që lahen nën djersët e ditës

49

SHIRAT BIEN KËTU DUKE LOZUR

Thonë se kur bie shi në qytetin tim
Rrugicat e ngushta
Mbushen me trishtim
Nuk ka se ku të rrjedh uji
Përpos nëpër oborre i përmbytë lulet

Shirat bien këtu duke lozur
Tangon e vjetër
Një muzikë e lashtë
Zgjohet në telat e qemanes
Dhe nuk ndalet asnjëherë kënga haleluja

Shiu i qyteti tim i ngjan lotit të nuseve
Kur i përcjellin burrat në luftë
Herë këndojnë e herë dënesin
Duke fshirë dhembjen
Me shamia përplot lara të kuqe

Ky shi i sotshëm që rrjedh ullukëve
Ka një tjetër shije
Pak i vjen era ujë e pak më shumë ndryshk
Nëpër lashtësinë e kalldrëmeve
Si për inat të kalimtarëve
Notojnë bretkosat e verdha

ADEM ZAPLLUZHA

SHIRAT BIEN KËTU DUKE LOZUR

Thonë se kur bie shi në qytetin tim
Rrugicat e ngushta
Mbushen me trishtim
Nuk ka se ku të rrjedh uji
Përpos nëpër oborre i përmbytë lulet

Shirat bien këtu duke lozur
Tangon e vjetër
Një muzikë e lashtë
Zgjohet në telat e qemanes
Dhe nuk ndalet asnjëherë kënga haleluja

Shiu i qyteti tim i ngjan lotit të nuseve
Kur i përcjellin burrat në luftë
Herë këndojnë e herë dënesin
Duke fshirë dhembjen
Me shamia përplot lara të kuqe

Ky shi i sotshëm që rrjedh ullukëve
Ka një tjetër shije
Pak i vjen era ujë e pak më shumë ndryshk
Nëpër lashtësinë e kalldrëmeve
Si për inat të kalimtarëve
Notojnë bretkosat e verdha

50

U BURRËRUAM DISI NËN HIJE

Ishin kohërat e vështira
Kur na kujtohet fëmijëria
Më duket se
Nuk ishim asnjëherë të vegjël
Na rriti dhuna dhe skamja para kohe

Ishim bosh nuk shkruanim as letra
Të dashurave tona
Që fshiheshin pas shtatë drynave
Të dyllta
Dhe ende s'janë shkrirë

Po të shikonim mes traversave
Të kalbura të tavanit
I gjejmë zarfet tona të kaltra
I gjejmë ende të djersitur
Shkruar nga duart që dridheshin si thupra

Ju thashë ne nuk ishim
Asnjëherë të vegjël
U burrëruam disi si nën hije
Në shkollë shkonim me opinga
Mbase gëzoheshim kur na cofte lopa

FLUTURAT E DJEGURA

U BURRËRUAM DISI NËN HIJE

Ishin kohërat e vështira
Kur na kujtohet fëmijëria
Më duket se
Nuk ishim asnjëherë të vegjël
Na rriti dhuna dhe skamja para kohe

Ishim bosh nuk shkruanim as letra
Të dashurave tona
Që fshiheshin pas shtatë drynave
Të dyllta
Dhe ende s'janë shkrirë

Po të shikonim mes traversave
Të kalbura të tavanit
I gjejmë zarfet tona të kaltra
I gjejmë ende të djersitur
Shkruar nga duart që dridheshin si thupra

Ju thashë ne nuk ishim
Asnjëherë të vegjël
U burrëruam disi si nën hije
Në shkollë shkonim me opinga
Mbase gëzoheshim kur na cofte lopa

51

ISHTE NJË LIBËR I VJETËR

Ju pata thënë me një rast
Se ne nuk kishim
Ku ta mbështesim kokën
Skamja ishte aq e madhe
Sa që përpos trastës së grisur
Nuk kishim ku ta vendosim abetaren

Ishte një libër i vjetër
I cili i shëmbëllente bukës
Garonim me gjyshen
E nënës plakë
Se kush do kujdesej më mirë
Ne për abetaren ose ajo për biblën

Kështu kjo garë na dukej
Që s'kishte të sosur
Edhe ajo ngjante një fëmije
Mes faqeve i kërkonte vargjet e Solomonit
Kurse ne si sytë tanë me xhelozi
I skalitnim në kokë shkronjat e alfabetit

ADEM ZAPLLUZHA

ISHTE NJË LIBËR I VJETËR

Ju pata thënë me një rast
Se ne nuk kishim
Ku ta mbështesim kokën
Skamja ishte aq e madhe
Sa që përpos trastës së grisur
Nuk kishim ku ta vendosim abetaren

Ishte një libër i vjetër
I cili i shëmbëllente bukës
Garonim me gjyshen
E nënës plakë
Se kush do kujdesej më mirë
Ne për abetaren ose ajo për biblën

Kështu kjo garë na dukej
Që s'kishte të sosur
Edhe ajo ngjante një fëmije
Mes faqeve i kërkonte vargjet e Solomonit
Kurse ne si sytë tanë me xhelozi
I skalitnim në kokë shkronjat e alfabetit

52

EDHE AJO PASKA MBETUR

Në çerdhet e zogjve
Mbi drurët halorë
Flenë ëndrrat e rinisë
Flenë zogjtë e trembur të vendlindjes
Ky atdhe i askujt
Nuk më dha një krodhe bukë

S'lashë derë pa trokitur
Pashë më pashë
I Kalova sinorët e huaj
Askund dielli nuk shkëlqente
Si në atdheun tim të mbetur peng
Mbetur në dorë të askujt

I shtrij duar kah zëri i faltoreve
Edhe ato paskan mbetur
Në pikë të hallit
Psalmet më nuk dëgjohen këtu
Këndohet në gjuhë të huaj
Thua se paska vdekur gjuha e lashtë shqipe

FLUTURAT E DJEGURA

EDHE AJO PASKA MBETUR

Në çerdhet e zogjve
Mbi drurët halorë
Flenë ëndrrat e rinisë
Flenë zogjtë e trembur të vendlindjes
Ky atdhe i askujt
Nuk më dha një krodhe bukë

S'lashë derë pa trokitur
Pashë më pashë
I Kalova sinorët e huaj
Askund dielli nuk shkëlqente
Si në atdheun tim të mbetur peng
Mbetur në dorë të askujt

I shtrij duar kah zëri i faltoreve
Edhe ato paskan mbetur
Në pikë të hallit
Psalmet më nuk dëgjohen këtu
Këndohet në gjuhë të huaj
Thua se paska vdekur gjuha e lashtë shqipe

53

KUR LARGOHEN EDHE SHTËRGJET E FUNDIT

Kur më rrëmbejnë trishtimet
Ti vjen ngadalë
Dhe si ora e maleve
Zgjon në mua
Alergjinë e pashërueshme

Nga duart e mia të lodhura
Pikojnë shirat
Si rreke derdhen rrufetë
Ai zjarr i mallit të lashtë
Nuk shuhet asnjëherë

Ndizen detet e kujtimeve
Flaka u del luadheve
Nuk kanë se ku të ikin
Fluturat e kaltra
Kur digjet si vullkan
Ky zjarr i pashuar në mua

Më thuaj si t'i thërras zogjtë
Të kthehen në atdhe
Kur largohen edhe shtërgjet e fundit
Kam mall për këtë dru
Të cilit asnjë det nuk ja shuan flakën

ADEM ZAPLLUZHA

KUR LARGOHEN EDHE SHTËRGJET E FUNDIT

Kur më rrëmbejnë trishtimet
Ti vjen ngadalë
Dhe si ora e maleve
Zgjon në mua
Alergjinë e pashërueshme

Nga duart e mia të lodhura
Pikojnë shirat
Si rreke derdhen rrufetë
Ai zjarr i mallit të lashtë
Nuk shuhet asnjëherë

Ndizen detet e kujtimeve
Flaka u del luadheve
Nuk kanë se ku të ikin
Fluturat e kaltra
Kur digjet si vullkan
Ky zjarr i pashuar në mua

Më thuaj si t'i thërras zogjtë
Të kthehen në atdhe
Kur largohen edhe shtërgjet e fundit
Kam mall për këtë dru
Të cilit asnjë det nuk ja shuan flakën

54

NËN DHE I DËGJOJMË GJËMAT E TOKËS

Kur mbi traversat e kalbura
Kotet treni i vjetër
Vjen ti
Dhe i zgjon kujtimet

Ulesh te supi im i drobitur
Dhe çukit
Si qukapiku drurin e kalbur
Nën dhe dëgjohen gjëmat e tokës

Nga kjo dynja e rrejshme
Nuk paska mbetur asnjë flutur
Po largohen edhe gjinkallat
Nga malli i zërit tim shkunden kujtimet

Të lutem nëse do ulu
Por mos e prek supin tim
Mos e prek se druaj
Do zgjohen perënditë e fjetur të Olimpit

FLUTURAT E DJEGURA

NËN DHE I DËGJOJMË GJËMAT E TOKËS

Kur mbi traversat e kalbura
Kotet treni i vjetër
Vjen ti
Dhe i zgjon kujtimet

Ulesh te supi im i drobitur
Dhe çukit
Si qukapiku drurin e kalbur
Nën dhe dëgjohen gjëmat e tokës

Nga kjo dynja e rrejshme
Nuk paska mbetur asnjë flutur
Po largohen edhe gjinkallat
Nga malli i zërit tim shkunden kujtimet

Të lutem nëse do ulu
Por mos e prek supin tim
Mos e prek se druaj
Do zgjohen perënditë e fjetur të Olimpit

55

DY FLUTURA TË KALTRA

Kur trungjet duken si njerëzit
Ullishtat vdesin
Nuk mbetet asnjë rrënjë
Në kujtesën e degës së dafinës
Ah liria e mallkuar
Dy ditë s’pata fat me ty

Me gishtat e mi skelet
Preka gjumin e drurëve
Preka trishtimin
I cili zuri vend në një boshllëk
Atë ditë te rrapet e lagjes
Kishin vdekur fluturat e bardha

Më duket se i pashë të vdekura
Edhe duart e mia
Asnjë gjymtyrë s’lëvizte në trupin tim
Dy flutura të kaltra
Qëndronin ulur mbi supin e erës
Dhe këndonin një këngë të lashtë mortore

ADEM ZAPLLUZHA

DY FLUTURA TË KALTRA

Kur trungjet duken si njerëzit
Ullishtat vdesin
Nuk mbetet asnjë rrënjë
Në kujtesën e degës së dafinës
Ah liria e mallkuar
Dy ditë s’pata fat me ty

Me gishtat e mi skelet
Preka gjumin e drurëve
Preka trishtimin
I cili zuri vend në një boshllëk
Atë ditë te rrapet e lagjes
Kishin vdekur fluturat e bardha

Më duket se i pashë të vdekura
Edhe duart e mia
Asnjë gjymtyrë s’lëvizte në trupin tim
Dy flutura të kaltra
Qëndronin ulur mbi supin e erës
Dhe këndonin një këngë të lashtë mortore

56

IM ATË NDJESË PASTË

Nuk më pyeti askush
Se si lindi dimri
Bora atë vit ishte e kuqe
Skuqur nga gjaku i drerit të vrarë
Ose qante stina
Mbi një baladë të vjetër shqiptare

Ah vitet e mia të brishta
Që u shndërruat në harresë
Asnjë zog i verbër nuk fluturoi
Mbi çerdhen time të braktisur
Nga u larguan lejlekët
Nëpër përrallat e krushqve të vrarë

Po ju them për të tretën herë
Nuk më pyetën për lindjen e dimrit
Ishte një mot i lig
Im atë ndjesë pastë
Shtatë herë e bleu pushkën e njëjtë
Por lëkura nuk i shpëtoi dot së regjuri

FLUTURAT E DJEGURA

IM ATË NDJESË PASTË

Nuk më pyeti askush
Se si lindi dimri
Bora atë vit ishte e kuqe
Skuqur nga gjaku i drerit të vrarë
Ose qante stina
Mbi një baladë të vjetër shqiptare

Ah vitet e mia të brishta
Që u shndërruat në harresë
Asnjë zog i verbër nuk fluturoi
Mbi çerdhen time të braktisur
Nga u larguan lejlekët
Nëpër përrallat e krushqve të vrarë

Po ju them për të tretën herë
Nuk më pyetën për lindjen e dimrit
Ishte një mot i lig
Im atë ndjesë pastë
Shtatë herë e bleu pushkën e njëjtë
Por lëkura nuk i shpëtoi dot së regjuri

57

NËN DEGËT E DAFINËS

Ja më në fund erdha te shtegu im
Këtu nuk më pret askush
As miqtë e mi
E as kali im i paçjerrë

Pranvera paska vdekur
Shumë herët sivjet
Nuk më kujtohet asnjëherë
Një vdekje e tillë e luleve

Nën degët e dafinës
Më priste një flutur
Më priste të ja dorëzoi amanetin
Të cilin as toka s’e tretë

Nëse sivjet nuk vjen pranvera
Çfarë do të bëj me fjalën time
Kujt të ja lë peng amanetin
Ky dimër që po vonon duket një ogur i zi

ADEM ZAPLLUZHA

NËN DEGËT E DAFINËS

Ja më në fund erdha te shtegu im
Këtu nuk më pret askush
As miqtë e mi
E as kali im i paçjerrë

Pranvera paska vdekur
Shumë herët sivjet
Nuk më kujtohet asnjëherë
Një vdekje e tillë e luleve

Nën degët e dafinës
Më priste një flutur
Më priste të ja dorëzoi amanetin
Të cilin as toka s’e tretë

Nëse sivjet nuk vjen pranvera
Çfarë do të bëj me fjalën time
Kujt të ja lë peng amanetin
Ky dimër që po vonon duket një ogur i zi

58

TE BIFURKACIONI I ETJES

Nuk është hera e parë
Që më zuri gjumi
Mes këtyre arabeskave abstrakte
Dielli gjithmonë ka lindur
Në anën e kundër të perëndimit
Kurse në këtë mëngjes vinte nga jugu

Nuk më pëlqeu kjo lindje
Por kush e pyet poetin
Nga cila anë e hemisferës
Do të niset me ardhur stina e baladave
Pak si vonë i mbollëm thekrat
Sivjet do të vonohen të korrurat

Te bifurkacioni i etjes
Befasisht u takova me vetveten
Pikë djerse
Nuk kishte mbetur në trupin tim
Edhe lindja e diellit dukej e çuditshme
Sivjet kishte mbetur pa itinerar

FLUTURAT E DJEGURA

TE BIFURKACIONI I ETJES

Nuk është hera e parë
Që më zuri gjumi
Mes këtyre arabeskave abstrakte
Dielli gjithmonë ka lindur
Në anën e kundër të perëndimit
Kurse në këtë mëngjes vinte nga jugu

Nuk më pëlqeu kjo lindje
Por kush e pyet poetin
Nga cila anë e hemisferës
Do të niset me ardhur stina e baladave
Pak si vonë i mbollëm thekrat
Sivjet do të vonohen të korrurat

Te bifurkacioni i etjes
Befasisht u takova me vetveten
Pikë djerse
Nuk kishte mbetur në trupin tim
Edhe lindja e diellit dukej e çuditshme
Sivjet kishte mbetur pa itinerar

59

NGA UNI IM KRYENEÇ

Nuk di a mundet koha
Me matur saktësisht
Çmendurinë time
Nga uni im kryeneç
Burojnë përrenjtë e legjendave
Lumenjtë me nga dy derdhje

Herë i shëmbëllej kuçedrës
E herë lepurit
Dy krijesa jetojnë në mua
Njëra i parapëlqen lulet e luadheve
Kurse tjetra çmendurisht
I adhuron rrapet që s'përkulen asnjëherë

Sa herë që ndryshojnë stinët
Unë zgjohem
Dhe përtëritem si gjelbërimi
Nga duart e mia të drobitura
Rrjedhin lumenjtë me të çmendur
Rrjedhin në të gjitha drejtimet e etjes

ADEM ZAPLLUZHA

NGA UNI IM KRYENEÇ

Nuk di a mundet koha
Me matur saktësisht
Çmendurinë time
Nga uni im kryeneç
Burojnë përrenjtë e legjendave
Lumenjtë me nga dy derdhje

Herë i shëmbëllej kuçedrës
E herë lepurit
Dy krijesa jetojnë në mua
Njëra i parapëlqen lulet e luadheve
Kurse tjetra çmendurisht
I adhuron rrapet që s'përkulen asnjëherë

Sa herë që ndryshojnë stinët
Unë zgjohem
Dhe përtëritem si gjelbërimi
Nga duart e mia të drobitura
Rrjedhin lumenjtë me të çmendur
Rrjedhin në të gjitha drejtimet e etjes

60

KEMI MËSUAR NGA LASHTËSITË

Ne mund ta ndryshojmë
Formën elipsoide të tokës
Gjininë e një njeriu asnjanës
Por kurrë në asnjë mënyrë
Nuk mund ta ndryshojmë vetveten

Kemi mësuar nga lashtësitë
E përrallave
Se kanë ekzistuar njerëz gjigantë
Që i kanë përpirë malet e stralltë
Por nuk mësuam se si ta mundim frikën

Me qindra mjeshtri që ekzistojnë
Në këtë botë
Mund të perfeksionohen
Por artin e dashurisë
Nuk jemi në gjendje ta mësojmë

FLUTURAT E DJEGURA

KEMI MËSUAR NGA LASHTËSITË

Ne mund ta ndryshojmë
Formën elipsoide të tokës
Gjininë e një njeriu asnjanës
Por kurrë në asnjë mënyrë
Nuk mund ta ndryshojmë vetveten

Kemi mësuar nga lashtësitë
E përrallave
Se kanë ekzistuar njerëz gjigantë
Që i kanë përpirë malet e stralltë
Por nuk mësuam se si ta mundim frikën

Me qindra mjeshtri që ekzistojnë
Në këtë botë
Mund të perfeksionohen
Por artin e dashurisë
Nuk jemi në gjendje ta mësojmë

61

Ne me shumë guxim mund ta ndryshojmë
Rrjedhën e ujit dhe të kohës
Por asnjëherë ama askurrë
Nuk mund të arrijmë
Si ta ndryshojmë vetveten

ADEM ZAPLLUZHA

Ne me shumë guxim mund ta ndryshojmë
Rrjedhën e ujit dhe të kohës
Por asnjëherë ama askurrë
Nuk mund të arrijmë
Si ta ndryshojmë vetveten

REBUSIN PËR VULËN E FJALËVE

Nuk të duhet shumë
Sa për t'i prekur gjërat e përditshme
Ke nevojë për pak guxim
Të fundosesh në shpirtin e lules

Më pastaj nga aroma e tokës
Huazoje shqisën e shtatë
Dhe më vonë merr udhë
Deri te ëndrrat e tua të pa ëndërruara

Nëse nuk ke me ke të bisedosh
Huazo nga kalorësit e apokalipsit
Rebusin për vulën e fjalëve
Ku mund t'i gjesh të gjitha parathëniet

Mos pyet shumë se e përjeton përmbytjen
Arka e Nojës
Është e ngarkuar me thashetheme
E cila mund të fundoset në shpirtin e zhurit

FLUTURAT E DJEGURA

REBUSIN PËR VULËN E FJALËVE

Nuk të duhet shumë
Sa për t'i prekur gjërat e përditshme
Ke nevojë për pak guxim
Të fundosesh në shpirtin e lules

Më pastaj nga aroma e tokës
Huazoje shqisën e shtatë
Dhe më vonë merr udhë
Deri te ëndrrat e tua të pa ëndërruara

Nëse nuk ke me ke të bisedosh
Huazo nga kalorësit e apokalipsit
Rebusin për vulën e fjalëve
Ku mund t'i gjesh të gjitha parathëniet

Mos pyet shumë se e përjeton përmbytjen
Arka e Nojës
Është e ngarkuar me thashetheme
E cila mund të fundoset në shpirtin e zhurit

63

MBASE JEMI SHNDËRRUAR

Kurrë nuk pushoi
Duke i rënë kambanës
Por më shumë se njëqind vjet
Nuk dëgjohet zëri i saj

S'dëgjohet as zëzëllima e mushkonjës
Vetëm të dielave
Kur përfundon mesha
Në oborrin e kishës nuk mejnë zërat

Më duket se janë po ata zëra
Asnjanëse
Që vijnë nga nëntoka
Mbase janë vigmat e etërve tanë

Pa dashje jemi shndërruar
Në njerëz shurdhmemec
Nga supet tona pa kurrfarë kujdesi
I shkundim zërat e piskamave të nëndheshme

ADEM ZAPLLUZHA

MBASE JEMI SHNDËRRUAR

Kurrë nuk pushoi
Duke i rënë kambanës
Por më shumë se njëqind vjet
Nuk dëgjohet zëri i saj

S'dëgjohet as zëzëllima e mushkonjës
Vetëm të dielave
Kur përfundon mesha
Në oborrin e kishës nuk mejnë zërat

Më duket se janë po ata zëra
Asnjanëse
Që vijnë nga nëntoka
Mbase janë vigmat e etërve tanë

Pa dashje jemi shndërruar
Në njerëz shurdhmemec
Nga supet tona pa kurrfarë kujdesi
I shkundim zërat e piskamave të nëndheshme

64

ISHTE NJË VJESHTË E ZEZË

Ajo pret te pragu
Pret të kthehen fluturimet
Në çdo stinë
E ndjen thellë vjeshtën në shpirt

Pragu i gurtë ose i drunjtë
S'ka rëndësi se si është
Kryesisht është prag i ftohtë
Ku priten dhe përcillen miqtë

Më kujtohet kur nga ky prag
E përcollëm babin në burg
I cili kurrë më
Nuk u kthye në shtëpi

Ishte një vjeshtë e zezë
Kur e kthyen
Me një arkivol të gozhduar
S'lejuan t'ia shohim as kufomën

FLUTURAT E DJEGURA

ISHTE NJË VJESHTË E ZEZË

Ajo pret te pragu
Pret të kthehen fluturimet
Në çdo stinë
E ndjen thellë vjeshtën në shpirt

Pragu i gurtë ose i drunjtë
S'ka rëndësi se si është
Kryesisht është prag i ftohtë
Ku priten dhe përcillen miqtë

Më kujtohet kur nga ky prag
E përcollëm babin në burg
I cili kurrë më
Nuk u kthye në shtëpi

Ishte një vjeshtë e zezë
Kur e kthyen
Me një arkivol të gozhduar
S'lejuan t'ia shohim as kufomën

65

ME NJË BALADË PREJ MJEGULLE

Njeriu asnjëherë nuk vdes
I ngjan fluturave të kaltra
Kridhet ka qiejt
Dhe bëhet një copë mjegulle
Po të vdiste
Nuk do të kishim kurrë mjegull

As etërit nuk na kanë vdekur
Llamburitin me lopate prej shiu
Nëpër hapësirat blu të qiellit
Saherë që i shikojmë lartësitë
I vërejmë duart prej mjegulle
Kah na përshëndesim

Ja pranë asaj mjegulle të pambuktë
E cila imiton mjekrën e gjyshit
Fshihen fluturimet
E të gjitha shtërgjeve nëpër acar
Fshihen që ta mashtrojnë stinën
Me një baladë prej mjegulle

Prishtinë, 9 prill 2018

ADEM ZAPLLUZHA

ME NJË BALADË PREJ MJEGULLE

Njeriu asnjëherë nuk vdes
I ngjan fluturave të kaltra
Kridhet ka qiejt
Dhe bëhet një copë mjegulle
Po të vdiste
Nuk do të kishim kurrë mjegull

As etërit nuk na kanë vdekur
Llamburitin me lopate prej shiu
Nëpër hapësirat blu të qiellit
Saherë që i shikojmë lartësitë
I vërejmë duart prej mjegulle
Kah na përshëndesim

Ja pranë asaj mjegulle të pambuktë
E cila imiton mjekrën e gjyshit
Fshihen fluturimet
E të gjitha shtërgjeve nëpër acar
Fshihen që ta mashtrojnë stinën
Me një baladë prej mjegulle

Prishtinë, 9 prill 2018

66

UNË NUK DUA TË VDES

Kjo pamje e verdhë metafizike
Në kaltërsinë e qiellit
Sa shumë i ngjanë syve të erës
Sa shumë u shëmbëllen luleshqerrave
Kur i mbulon mëngjesi me lotin e brishtë

Largoje shikimin surrealist
Po më ngufasin pamjet
Në pasqyrën konvekse
Kjo stinë e vjeljes së rrushit
Më duket se është vonuar për disa javë

Mbrëmë nga selvitë e lagjes
Fluturuan zogjtë e fëmijërisë
Asnjë flutur e djegur nuk mbeti
Mes gjetheve të fishkura
Mbase paska vdekur edhe stina

FLUTURAT E DJEGURA

UNË NUK DUA TË VDES

Kjo pamje e verdhë metafizike
Në kaltërsinë e qiellit
Sa shumë i ngjanë syve të erës
Sa shumë u shëmbëllen luleshqerrave
Kur i mbulon mëngjesi me lotin e brishtë

Largoje shikimin surrealist
Po më ngufasin pamjet
Në pasqyrën konvekse
Kjo stinë e vjeljes së rrushit
Më duket se është vonuar për disa javë

Mbrëmë nga selvitë e lagjes
Fluturuan zogjtë e fëmijërisë
Asnjë flutur e djegur nuk mbeti
Mes gjetheve të fishkura
Mbase paska vdekur edhe stina

67

Unë nuk dua të vdes
Nuk dua sepse nuk e pranoj formën e saj
Vdesin gjësendet dhe lodrat e fëmijërisë
Por njeriu kurrë nuk vdes
Mbi shpatullat e erës kalbet qefini

ADEM ZAPLLUZHA

Unë nuk dua të vdes
Nuk dua sepse nuk e pranoj formën e saj
Vdesin gjësendet dhe lodrat e fëmijërisë
Por njeriu kurrë nuk vdes
Mbi shpatullat e erës kalbet qefini

ISHIN TË MBYLLURA PËR NE

Më duket se ishin çmendur
Kanatat e dritareve
Asnjë xham s’kishte mbetur
Në kornizat e kalbura
Vetëm era e mykur
I hapte dhe mbyllte dyert

Mushkonjat nuk i pengonte honi
I pafund
Fillimi dukej si një mashtrim optik
Në kopshtin e çrregulluar
Qante një kalama
Qante të ardhmen e një stine

Fëmijët e lagjes barkcullak
Vraponin kalldrëmeve pa gajle
Selvitë e buta
Shikonin me xhelozi
Shelgun e pikëlluar
Shikonin dhe s’besonin se edhe ai këndon

FLUTURAT E DJEGURA

ISHIN TË MBYLLURA PËR NE

Më duket se ishin çmendur
Kanatat e dritareve
Asnjë xham s’kishte mbetur
Në kornizat e kalbura
Vetëm era e mykur
I hapte dhe mbyllte dyert

Mushkonjat nuk i pengonte honi
I pafund
Fillimi dukej si një mashtrim optik
Në kopshtin e çrregulluar
Qante një kalama
Qante të ardhmen e një stine

Fëmijët e lagjes barkcullak
Vraponin kalldrëmeve pa gajle
Selvitë e buta
Shikonin me xhelozi
Shelgun e pikëlluar
Shikonin dhe s’besonin se edhe ai këndon

69

Kurse shiu monoton troket
E troket në kanatat e dritareve
Me xhama të thyera
Troket në portat e historisë
Të cilat gjithmonë
Ishin të mbyllura për ne

ADEM ZAPLLUZHA

Kurse shiu monoton troket
E troket në kanatat e dritareve
Me xhama të thyera
Troket në portat e historisë
Të cilat gjithmonë
Ishin të mbyllura për ne

KY SHI I HIDHUR

Që kur filluan të fluturojnë zogjtë
Korbat e bardhë
Në një varr të qytetit im
I dëgjojnë britmat e tokës
Ato vigma
Që të bëjnë të rrëqethësh

Një lojë e lashtë e ndërgjegjes
S'pushon askurrë
Vithisja e hapur si goja e katallanit
S'mbyllet dot nga britmat
Varri i shqetësuar
Po përjeton tërmetin e dytë

Britmat dhe piskamat
S'kanë të pushuar në këto varre
Nuk pushojnë as të reshurat
Ky shi i hidhur
Që po rigon sot me trishtim
Mbase qenka loti i të harruarve

FLUTURAT E DJEGURA

KY SHI I HIDHUR

Që kur filluan të fluturojnë zogjtë
Korbat e bardhë
Në një varr të qytetit im
I dëgjojnë britmat e tokës
Ato vigma
Që të bëjnë të rrëqethësh

Një lojë e lashtë e ndërgjegjes
S'pushon askurrë
Vithisja e hapur si goja e katallanit
S'mbyllet dot nga britmat
Varri i shqetësuar
Po përjeton tërmetin e dytë

Britmat dhe piskamat
S'kanë të pushuar në këto varre
Nuk pushojnë as të reshurat
Ky shi i hidhur
Që po rigon sot me trishtim
Mbase qenka loti i të harruarve

71

FLUTURAT E DJEGURA

Me fytyra të lodhura
Trishtueshëm na shikojnë statujat
Era frynë nëpër zgërbonja drurësh
Frynë e nuk u mejnë asnjëherë vajtimet
E shiu te gjethet
Troket si i budallakosur nëpër xhama

Në kopsht ku janë varrosur
Fluturat e djegura
Për çdo ditë një qyqe e zgërlaqur
Zbret të shelgjet dhe këndon
Një këngë të vjetër vaji
Këndon e nuk men asnjëherë

Bari si i hutuar tërë pikëllim
Përcjell me një pamje habitore
Simfoninë e një kompozitori anonim
Kurse gjelbërimi i fishkur
Mbi njëqind e më shumë vjet
Nuk çeli asnjë shpresë prej luleborës

ADEM ZAPLLUZHA

FLUTURAT E DJEGURA

Me fytyra të lodhura
Trishtueshëm na shikojnë statujat
Era frynë nëpër zgërbonja drurësh
Frynë e nuk u mejnë asnjëherë vajtimet
E shiu te gjethet
Troket si i budallakosur nëpër xhama

Në kopsht ku janë varrosur
Fluturat e djegura
Për çdo ditë një qyqe e zgërlaqur
Zbret të shelgjet dhe këndon
Një këngë të vjetër vaji
Këndon e nuk men asnjëherë

Bari si i hutuar tërë pikëllim
Përcjell me një pamje habitore
Simfoninë e një kompozitori anonim
Kurse gjelbërimi i fishkur
Mbi njëqind e më shumë vjet
Nuk çeli asnjë shpresë prej luleborës

72

STINA SIVJET ISHTE E BEGATË

Ka rënë mbrëmja
Pas maleve fshihet dielli
Drita abdikoi si mbreti i çmendur
Nën pjergullën e kuqe
Nuk mejnë zërat asnjanëse të gjinkallave

Nga lagja e evgjitëve
Si një nostalgji e lashtë
Dëgjohen notat e shthurura të gërnetës
Mbi plepishte me afsh këndon
Këndesi i moshuar i fshatit

Nga taverna e vjetër nëpër ajrin e plasaritur
Si mbretëreshë zbret
Duhma e verës së kuqe
Stina sivjet ishte e begatë
Rrushit të Kosovës i grisej lëkura

FLUTURAT E DJEGURA

STINA SIVJET ISHTE E BEGATË

Ka rënë mbrëmja
Pas maleve fshihet dielli
Drita abdikoi si mbreti i çmendur
Nën pjergullën e kuqe
Nuk mejnë zërat asnjanëse të gjinkallave

Nga lagja e evgjitëve
Si një nostalgji e lashtë
Dëgjohen notat e shthurura të gërnetës
Mbi plepishte me afsh këndon
Këndesi i moshuar i fshatit

Nga taverna e vjetër nëpër ajrin e plasaritur
Si mbretëreshë zbret
Duhma e verës së kuqe
Stina sivjet ishte e begatë
Rrushit të Kosovës i grisej lëkura

73

Pak më vonë kur nata i kaloi malet
Filluan të këndojnë gotat
Mejhanexhiu i dehur
Ja nisi një melodie të lashtë
Ja nisi e fërshëllente thua se po vajton era

ADEM ZAPLLUZHA

Pak më vonë kur nata i kaloi malet
Filluan të këndojnë gotat
Mejhanexhiu i dehur
Ja nisi një melodie të lashtë
Ja nisi e fërshëllente thua se po vajton era

PIKONTE NJË LLOJ LOTI

Ajo ishte ulur te pragu i gurtë
Dhe me nostalgji
I përcillte fluturimet e zogjve
Ishte një nënë e shtatë fëmijëve
Pa asnjë djep të mirëfilltë
Në oxhakun e lënë shkretë

Ka kohë që ka harruar
Se si duhet përkundur një kërthi
Dhe lidhet foshnja në djep
Shikonte dhe nga syri i majtë
Pikonte një lloj loti
Po ai lot që ja verboi syrin e djathtë

Te pragu i gurtë çdo ditë pret
Kthimin e fluturave
Shtërgjet shkojnë e vijnë
Mbi oxhakun e një çatie të harruar
E kjo nënë pa asnjë djep
Me syrin e majtë ende shikon horizontin

FLUTURAT E DJEGURA

PIKONTE NJË LLOJ LOTI

Ajo ishte ulur te pragu i gurtë
Dhe me nostalgji
I përcillte fluturimet e zogjve
Ishte një nënë e shtatë fëmijëve
Pa asnjë djep të mirëfilltë
Në oxhakun e lënë shkretë

Ka kohë që ka harruar
Se si duhet përkundur një kërthi
Dhe lidhet foshnja në djep
Shikonte dhe nga syri i majtë
Pikonte një lloj loti
Po ai lot që ja verboi syrin e djathtë

Te pragu i gurtë çdo ditë pret
Kthimin e fluturave
Shtërgjet shkojnë e vijnë
Mbi oxhakun e një çatie të harruar
E kjo nënë pa asnjë djep
Me syrin e majtë ende shikon horizontin

75

U BËRA ZË TË GJITHA MUZAVE

Mbrëmë poezia ishte shurdhmemece
Nuk bëzante asnjë fjalë
Kishte mbetur pa gjuhë
E shqisa
Një zog i lig
Këndonte në çerdhen e tij

U bëra zë të gjitha muzave
Më duket se
Kishin vdekur perënditë e Olimpit
Asnjë zot nuk pat takat
T'i urdhëroi muzat
Të zbresin në Fushën e Mëllenjave

U nemitën drutë e gurtë
Zë njeriu
Nuk lëshoi lumi i shterur
As zhuri i murrmë s'pati guxim
Të këndoj këngën e algave
Ishte një vdekje e pështirë e fluturave

ADEM ZAPLLUZHA

U BËRA ZË TË GJITHA MUZAVE

Mbrëmë poezia ishte shurdhmemece
Nuk bëzante asnjë fjalë
Kishte mbetur pa gjuhë
E shqisa
Një zog i lig
Këndonte në çerdhen e tij

U bëra zë të gjitha muzave
Më duket se
Kishin vdekur perënditë e Olimpit
Asnjë zot nuk pat takat
T'i urdhëroi muzat
Të zbresin në Fushën e Mëllenjave

U nemitën drutë e gurtë
Zë njeriu
Nuk lëshoi lumi i shterur
As zhuri i murrmë s'pati guxim
Të këndoj këngën e algave
Ishte një vdekje e pështirë e fluturave

76

STINA VEÇ KA FILLUAR

Unë dhe nusja ime
Në shiun e verdhë të pranverës
Kemi mbetur si dy kërcu
Nëpër korridoret e zbrazëta
Hingëllojnë kuajt e drunjtë
Nuk ka se kush
Me ua lidh më gojëzat galopeve

Era po luan një tango të lashtë
Pasqyra e vjetër
Habitshëm shikon në errësirë
Vallen e vjetër të një fisi dardan
Shikonin duke i fshirë lotët
Nga një mall i lashtë
E i pashkruar shkunden kujtimet

Gjethet e verdha kanë zënë e po kalben
Në kopshtin e lënë pas dore
Stina veç ka filluar
Me i tregua dhëmbët e acarit
Një dimër i pështirë
Po zbret nga gryka e maleve
Druaj se do ngrihen pemët e njoma sivjet

FLUTURAT E DJEGURA

STINA VEÇ KA FILLUAR

Unë dhe nusja ime
Në shiun e verdhë të pranverës
Kemi mbetur si dy kërcu
Nëpër korridoret e zbrazëta
Hingëllojnë kuajt e drunjtë
Nuk ka se kush
Me ua lidh më gojëzat galopeve

Era po luan një tango të lashtë
Pasqyra e vjetër
Habitshëm shikon në errësirë
Vallen e vjetër të një fisi dardan
Shikonin duke i fshirë lotët
Nga një mall i lashtë
E i pashkruar shkunden kujtimet

Gjethet e verdha kanë zënë e po kalben
Në kopshtin e lënë pas dore
Stina veç ka filluar
Me i tregua dhëmbët e acarit
Një dimër i pështirë
Po zbret nga gryka e maleve
Druaj se do ngrihen pemët e njoma sivjet

77

SA LARG QENKA MËNGJESI

Sonte nuk ndriçojnë llambat
Mbase vuajnë nga lia e zezë
Nëpër shëtitore
Enden trotuaret e vetmuar
Kjo verbëri e shpirtit nuk paska fund

Një zë si ai i kambanës
Zbret nga oborri i braktisur i kishës
Jashtë portave të rënda
Kanë zënë e po fryjnë erërat e liga
Pleqtë pohojnë se lufta nuk është larg

Asnjë dritë nuk vjen nga qielli i sterrët
Më duket se meteorët me bisht
Ja kanë zënë dritën hënës
Ka kohë që nuk dëgjohen këndesat
Sa larg qenka mëngjesi

Prishtinë, 11 prill 2018

ADEM ZAPLLUZHA

SA LARG QENKA MËNGJESI

Sonte nuk ndriçojnë llambat
Mbase vuajnë nga lia e zezë
Nëpër shëtitore
Enden trotuaret e vetmuar
Kjo verbëri e shpirtit nuk paska fund

Një zë si ai i kambanës
Zbret nga oborri i braktisur i kishës
Jashtë portave të rënda
Kanë zënë e po fryjnë erërat e liga
Pleqtë pohojnë se lufta nuk është larg

Asnjë dritë nuk vjen nga qielli i sterrët
Më duket se meteorët me bisht
Ja kanë zënë dritën hënës
Ka kohë që nuk dëgjohen këndesat
Sa larg qenka mëngjesi

Prishtinë, 11 prill 2018

78

Cikli i tretë
Diku në horizontin e pafund

FLUTURAT E DJEGURA

Cikli i tretë
Diku në horizontin e pafund

79

ADEM ZAPLLUZHA

80

NUK MË MBETI ASNJË UDHË TJETËR

Pak nga pak po e hamë rrugën me sy
Ka mbetur vetëm t'i kapërcejmë malet
Atje në fund përtej detit
Në rremat e varkës së fundosur
Shtrihet një tjetër det

Herë ngriten dallgët
E herë lëshohen pingul
Deri te zhuri e murrmë i Jonit
Loti i peshkut fluturues s'ndalet dot
Ky mot i lig po i përpinë të gjitha kujtimet

Nuk më mbeti asnjë udhë tjetër
Përpos t'i dorëzoj armët
Kjo kohë që na ka mbetur peng
Në trungun e rrapit të lagjes
Pamëshirshëm po i mpreh dhëmbët

Në shumë drejtime frynë erërat
Detet kanë mbetur pa asnjë fjalë
Tasat e konservave rreziten në breg
Deri në fund të fjalës së humbur
Brigjet i kanë lëshuar spirancat

FLUTURAT E DJEGURA

NUK MË MBETI ASNJË UDHË TJETËR

Pak nga pak po e hamë rrugën me sy
Ka mbetur vetëm t'i kapërcejmë malet
Atje në fund përtej detit
Në rremat e varkës së fundosur
Shtrihet një tjetër det

Herë ngriten dallgët
E herë lëshohen pingul
Deri te zhuri e murrmë i Jonit
Loti i peshkut fluturues s'ndalet dot
Ky mot i lig po i përpinë të gjitha kujtimet

Nuk më mbeti asnjë udhë tjetër
Përpos t'i dorëzoj armët
Kjo kohë që na ka mbetur peng
Në trungun e rrapit të lagjes
Pamëshirshëm po i mpreh dhëmbët

Në shumë drejtime frynë erërat
Detet kanë mbetur pa asnjë fjalë
Tasat e konservave rreziten në breg
Deri në fund të fjalës së humbur
Brigjet i kanë lëshuar spirancat

81

NËPËR PORTAT E MBYLLURA

Sonte po bie një shi i myktë
Nesër nuk dimë
Se në çfarë do shëmbëllejnë lulet
I kemi përgatitur varkat
Ndoshta do përjetojmë si çdo herë
Çmendurinë e fundosjes së detit

Nëpër portat e mbyllura
Një kohë të gjatë
Nuk u ndalën të trokiturat
Nga pragjet e ronitur ikën fluturat
Asnjë pëllumb s'dëgjohej
Mbi çatinë e lënë peng kohës

Ende po rigon shiu i mbrëmshëm
Ky mëngjes
Nuk na solli asnjë ndryshim
Vetëm se i pamë zogjtë e hekurt
Mbi qiellin e vranët të atdheut
I pamë
Kah fluturonin të ngarkuar me trishtim

ADEM ZAPLLUZHA

NËPËR PORTAT E MBYLLURA

Sonte po bie një shi i myktë
Nesër nuk dimë
Se në çfarë do shëmbëllejnë lulet
I kemi përgatitur varkat
Ndoshta do përjetojmë si çdo herë
Çmendurinë e fundosjes së detit

Nëpër portat e mbyllura
Një kohë të gjatë
Nuk u ndalën të trokiturat
Nga pragjet e ronitur ikën fluturat
Asnjë pëllumb s'dëgjohej
Mbi çatinë e lënë peng kohës

Ende po rigon shiu i mbrëmshëm
Ky mëngjes
Nuk na solli asnjë ndryshim
Vetëm se i pamë zogjtë e hekurt
Mbi qiellin e vranët të atdheut
I pamë
Kah fluturonin të ngarkuar me trishtim

82

MUND TË BLESH ÇDO GJË DHE ASGJË

Më janë zbrazur xhepat
Ky treg me mallra të dyshimtë
Nuk i ngjan asgjëje përpos
Një deti të çmendur

Në këtë lagje nuk ke se çfarë të blesh
As të shesësh diçka me vlerë
Çdo gjë këtu për çastin
Ndryshon nga situata meteorologjike

Goma të vjetra automjetesh
Dhe pedale biçikletash
Të rrinë para syve
Si epitafet e varreve të rrënuara

Ky treg pa tregtarë të mirëfilltë
E ka humbur udhën në mes të ditës
Prej lindjes deri në perëndim të diellit
Mund të blesh çdo gjë dhe asgjë

FLUTURAT E DJEGURA

MUND TË BLESH ÇDO GJË DHE ASGJË

Më janë zbrazur xhepat
Ky treg me mallra të dyshimtë
Nuk i ngjan asgjëje përpos
Një deti të çmendur

Në këtë lagje nuk ke se çfarë të blesh
As të shesësh diçka me vlerë
Çdo gjë këtu për çastin
Ndryshon nga situata meteorologjike

Goma të vjetra automjetesh
Dhe pedale biçikletash
Të rrinë para syve
Si epitafet e varreve të rrënuara

Ky treg pa tregtarë të mirëfilltë
E ka humbur udhën në mes të ditës
Prej lindjes deri në perëndim të diellit
Mund të blesh çdo gjë dhe asgjë

83

MBYLLIN SYTË E METALTË

Shikoj një maskë të zezë
Pas së cilës
Zgërdheshet fytyra
Më e zezë se maska
Dielli me të dy duart i mbyllë sytë

Nëpër rrugë gazeta të hedhura
Lecka dhe çorape të grisura
Me një kundërmim të pakëndshëm
Asnjë bubuzhelë sot nuk pashë
Nëpër trotuaret e qytetit

Shëtitorja e zbrazët
Pa njerëz
Vetëm përmendoret e bronzta
I mbyllin sytë e metaltë
I mbyllin nga pamjet bizare

ADEM ZAPLLUZHA

MBYLLIN SYTË E METALTË

Shikoj një maskë të zezë
Pas së cilës
Zgërdheshet fytyra
Më e zezë se maska
Dielli me të dy duart i mbyllë sytë

Nëpër rrugë gazeta të hedhura
Lecka dhe çorape të grisura
Me një kundërmim të pakëndshëm
Asnjë bubuzhelë sot nuk pashë
Nëpër trotuaret e qytetit

Shëtitorja e zbrazët
Pa njerëz
Vetëm përmendoret e bronzta
I mbyllin sytë e metaltë
I mbyllin nga pamjet bizare

84

DIKU NË HORIZONTIN E PAFUND

Këtu në këtë mol
Varkat e vjetra duke u tundur
Gjithmonë kthehen në mbrëmje
Të lodhura deri në infinit
Fanari i kyçur rri me gojë të hapur
Një befasi tronditëse fle në shpirtin e ujit

Fanari dhe taverna aty afër
Bisedojnë me nostalgji
Për ditët që ikën
Dhe për peshkun magjik
Që kurrë nuk e preku
Rrjetën vdekjeprurës të merimangës

Dy marinarë të dehur
Në shenjë përshëndetjeje
Përqafojnë me afsh
Një shtyllë të vjetër telegrafike
Diku në horizontin e pafund
Puthen dy mjellma të bardha

FLUTURAT E DJEGURA

DIKU NË HORIZONTIN E PAFUND

Këtu në këtë mol
Varkat e vjetra duke u tundur
Gjithmonë kthehen në mbrëmje
Të lodhura deri në infinit
Fanari i kyçur rri me gojë të hapur
Një befasi tronditëse fle në shpirtin e ujit

Fanari dhe taverna aty afër
Bisedojnë me nostalgji
Për ditët që ikën
Dhe për peshkun magjik
Që kurrë nuk e preku
Rrjetën vdekjeprurës të merimangës

Dy marinarë të dehur
Në shenjë përshëndetjeje
Përqafojnë me afsh
Një shtyllë të vjetër telegrafike
Diku në horizontin e pafund
Puthen dy mjellma të bardha

85

Dikur vonë shumë vonë
Kur zhduket arusha e madhe
Qielli lakuriq
Si në ëndërr imiton yjet endacakë
Nën dallgët që se njohin pushimin
Një dunë prej uji këndon një serenatë

ADEM ZAPLLUZHA

Dikur vonë shumë vonë
Kur zhduket arusha e madhe
Qielli lakuriq
Si në ëndërr imiton yjet endacakë
Nën dallgët që se njohin pushimin
Një dunë prej uji këndon një serenatë

NJË ANIJE ME RREMA TË GJATA

Sonte pulëbardhat
Duken si delet e bardha të Jonit
Në kaltërsinë e pashpjegueshëm të detit
Një fluturim i egër
I shqiponjës së gdhendur
Nga një kështjellë e rrënuar
Fluturoi drejt hapësirave

Kalatë e lashta mijëvjeçare
Përcjellin me krenari
Rrymimin e valëve
Anija fantazmë me rrema të gjata
I rreh brigjet e historisë
I rreh pa mëshirë
Duke përgjuar luftëtarët e Pashait

Kurse në grykën e Këlcyrës
Ariu i murrmë i Ballkanit kryeneç
Ia lëpinë plagët e pashëruara të atdheut
Plagët që kullojnë gjak shekullor
Nga një inat dot
Që vështirë të shpjegohet edhe sot

FLUTURAT E DJEGURA

NJË ANIJE ME RREMA TË GJATA

Sonte pulëbardhat
Duken si delet e bardha të Jonit
Në kaltërsinë e pashpjegueshëm të detit
Një fluturim i egër
I shqiponjës së gdhendur
Nga një kështjellë e rrënuar
Fluturoi drejt hapësirave

Kalatë e lashta mijëvjeçare
Përcjellin me krenari
Rrymimin e valëve
Anija fantazmë me rrema të gjata
I rreh brigjet e historisë
I rreh pa mëshirë
Duke përgjuar luftëtarët e Pashait

Kurse në grykën e Këlcyrës
Ariu i murrmë i Ballkanit kryeneç
Ia lëpinë plagët e pashëruara të atdheut
Plagët që kullojnë gjak shekullor
Nga një inat dot
Që vështirë të shpjegohet edhe sot

87

DHUNOI JO VETËM NJERËZIT POR EDHE VARRET

Dy vinjeta
Mbi muranën e një përralle
Përgjojnë heshtjen e gjembave
Nga vazoja e kujtimeve
Të adoleshencës
Fluturuan dy mëllenja të zeza

Një kujtim dhe një lule
E cila paska harruar të fishket
Sot mbiu sërish
Në mendjen time të lodhur
Ajo më nuk është në mesin tonë
Te një varr i dyshimtë ja mbollëm kryqin

Mu te ai varr i cili më nuk ekziston
Sot lozin kalamajtë
Me kuajt e tyre prej druri
Erdhi një ushtri e huaj
Dhe fare pa i pyetur qytetarët
Dhunoi jo vetëm njerëzit por edhe varret

ADEM ZAPLLUZHA

DHUNOI JO VETËM NJERËZIT POR EDHE VARRET

Dy vinjeta
Mbi muranën e një përralle
Përgjojnë heshtjen e gjembave
Nga vazoja e kujtimeve
Të adoleshencës
Fluturuan dy mëllenja të zeza

Një kujtim dhe një lule
E cila paska harruar të fishket
Sot mbiu sërish
Në mendjen time të lodhur
Ajo më nuk është në mesin tonë
Te një varr i dyshimtë ja mbollëm kryqin

Mu te ai varr i cili më nuk ekziston
Sot lozin kalamajtë
Me kuajt e tyre prej druri
Erdhi një ushtri e huaj
Dhe fare pa i pyetur qytetarët
Dhunoi jo vetëm njerëzit por edhe varret

88

NË TOKËN E ETËRVE TË MI DARDAN

Kur të vdes vendosni hirin tim
Në ndonjë hinore prej argjile
Mos prekni asnjë pëllëmbë të kësaj toke
Për varrimin tim
Aq shumë janë gërryer këto male
Sa që nuk ka mbetur
As dy gishta vend për bozhuret

Kur të vdes lëni të hapur një dritare
T'i shoh ikjet e korbave
Kah largohen
Nga Fusha së Mëllenjave
Të ua shoh shpinën çafkave
Të cilat një kohë të gjatë
Po e gërryejnë atdheun tim

Kur të vdes nuk dua asnjë pemë
Të mbillet te koka
Nuk dua t'ua afroj kënaqësinë
Zogjve të paftuar
Të ulen e të bëjnë glasa korbat katran
Të bëjnë glasa
Në tokën e etërve të mi dardan

FLUTURAT E DJEGURA

NË TOKËN E ETËRVE TË MI DARDAN

Kur të vdes vendosni hirin tim
Në ndonjë hinore prej argjile
Mos prekni asnjë pëllëmbë të kësaj toke
Për varrimin tim
Aq shumë janë gërryer këto male
Sa që nuk ka mbetur
As dy gishta vend për bozhuret

Kur të vdes lëni të hapur një dritare
T'i shoh ikjet e korbave
Kah largohen
Nga Fusha së Mëllenjave
Të ua shoh shpinën çafkave
Të cilat një kohë të gjatë
Po e gërryejnë atdheun tim

Kur të vdes nuk dua asnjë pemë
Të mbillet te koka
Nuk dua t'ua afroj kënaqësinë
Zogjve të paftuar
Të ulen e të bëjnë glasa korbat katran
Të bëjnë glasa
Në tokën e etërve të mi dardan

89

MBI SUPET E PLAGOSURA TË IKONAVE

Për çdo ditë të Zotit
Sa herë që ndizen qirinjtë
Shoh kah po largohen
Fluturat e djegura

Po mbetemi në dorë të huaj
Tokë e askujt
Dhembja ime e pashëruar

Shikoj kanavacat e varura
Nëpër mure dhembjesh
Asnjë flutur nuk duket

Paskan ikur të gjitha ngjyrat
Atdheu lakuriq shikon
Kah digjen zjarret e mëdha
Mbi supet e plagosura të ikonave
Po dënesin etërit e mi krenarë

ADEM ZAPLLUZHA

MBI SUPET E PLAGOSURA TË IKONAVE

Për çdo ditë të Zotit
Sa herë që ndizen qirinjtë
Shoh kah po largohen
Fluturat e djegura

Po mbetemi në dorë të huaj
Tokë e askujt
Dhembja ime e pashëruar

Shikoj kanavacat e varura
Nëpër mure dhembjesh
Asnjë flutur nuk duket

Paskan ikur të gjitha ngjyrat
Atdheu lakuriq shikon
Kah digjen zjarret e mëdha
Mbi supet e plagosura të ikonave
Po dënesin etërit e mi krenarë

90

JU QË KAPITULLUAT NË KUMANOVË

Ju që kapitulluat në Kumanovë
Çfarë kërkoni nga etërit e mi
Mos e teproni
Me kërkesat e juaja megalomane

Mos kaq shumë
Se do ju mallkoj gjaku i martirëve
Dhe nuseve
Të dhunuara në praninë e fëmijëve

Çfarë është tepër
Tepër është
Mos e teproni se ju vret buka
Që e hëngrët mbi njëqind vjet

Ju që kapitulluat në Kumanovë
Njëherë e përgjithmonë
I dorëzuat armët
Tani uleni bishtin dhe kërkoni falje

Kërkoni nga gjaku i derdhur
I fëmijëve në bark të nuseve
Kërkoni falje
Se nesër do iu mallkoj historia

FLUTURAT E DJEGURA

JU QË KAPITULLUAT NË KUMANOVË

Ju që kapitulluat në Kumanovë
Çfarë kërkoni nga etërit e mi
Mos e teproni
Me kërkesat e juaja megalomane

Mos kaq shumë
Se do ju mallkoj gjaku i martirëve
Dhe nuseve
Të dhunuara në praninë e fëmijëve

Çfarë është tepër
Tepër është
Mos e teproni se ju vret buka
Që e hëngrët mbi njëqind vjet

Ju që kapitulluat në Kumanovë
Njëherë e përgjithmonë
I dorëzuat armët
Tani uleni bishtin dhe kërkoni falje

Kërkoni nga gjaku i derdhur
I fëmijëve në bark të nuseve
Kërkoni falje
Se nesër do iu mallkoj historia

91

SONTE KAM TË FTOHTË

Më janë harxhuar fjalët
U dorëzua Troja e shpirtit tim
Me kë të flas sonte
Kur kjo hënë e mermertë
Zhvishet deri në asht

Ju lutem mos m'i prekni ëndrrat
Paskam mbetur një kërcu i vetmuar
Kjo pemë e ky lis
Mbi dy mijë vjet kanë mbetur
Fare pa plis

Dimri sivjet trokiti më herët
Trokiti me tërë dhembjen e gurit
I ngriu pemët e egra
Ullinjtë s'do çelin lule
Më së paku edhe dyqind vjet

Sonte kam të ftohtë
Kjo hënë prej guri
Ose qielli i mermertë
Qenkan fundosur në gjakun tim
Dhe u shëmbëllejnë ushejzave të kuqe

ADEM ZAPLLUZHA

SONTE KAM TË FTOHTË

Më janë harxhuar fjalët
U dorëzua Troja e shpirtit tim
Me kë të flas sonte
Kur kjo hënë e mermertë
Zhvishet deri në asht

Ju lutem mos m'i prekni ëndrrat
Paskam mbetur një kërcu i vetmuar
Kjo pemë e ky lis
Mbi dy mijë vjet kanë mbetur
Fare pa plis

Dimri sivjet trokiti më herët
Trokiti me tërë dhembjen e gurit
I ngriu pemët e egra
Ullinjtë s'do çelin lule
Më së paku edhe dyqind vjet

Sonte kam të ftohtë
Kjo hënë prej guri
Ose qielli i mermertë
Qenkan fundosur në gjakun tim
Dhe u shëmbëllejnë ushejzave të kuqe

92

KJO PEMË BIBLIKE

Nuk jam më në lëkurën time
Më plagosën egërsisht cerberët
Nuk më lënë asnjë rrugë
Të futem deri te portat e premtuara

Nga lartë më shikonte
Hëna e plumbtë
Kurse nën tokë ku preknin këmbët
Rrëshqiti toka deltinore
Me çfarë dheu të gatuaj njeriun e ri

Shikoj përpjetë qiellit
Arusha e madhe i frikon yjet
Asnjë meteor nuk zbriti sonte
Si mund ta parashikoj fatin tim
Pas rënies së Trojës ranë të gjitha qytetet

Edhe kësaj here si në kopshtin e Edenit
Fajin e kishte molla
Kjo pemë biblike
Po e kafshove t'i thyen dhëmbët
Nëse nuk kafshon je i kafshuar ti

FLUTURAT E DJEGURA

KJO PEMË BIBLIKE

Nuk jam më në lëkurën time
Më plagosën egërsisht cerberët
Nuk më lënë asnjë rrugë
Të futem deri te portat e premtuara

Nga lartë më shikonte
Hëna e plumbtë
Kurse nën tokë ku preknin këmbët
Rrëshqiti toka deltinore
Me çfarë dheu të gatuaj njeriun e ri

Shikoj përpjetë qiellit
Arusha e madhe i frikon yjet
Asnjë meteor nuk zbriti sonte
Si mund ta parashikoj fatin tim
Pas rënies së Trojës ranë të gjitha qytetet

Edhe kësaj here si në kopshtin e Edenit
Fajin e kishte molla
Kjo pemë biblike
Po e kafshove t'i thyen dhëmbët
Nëse nuk kafshon je i kafshuar ti

93

SECILI NJERI ME YLLIN E VET

Mbrëmë i pashë kah fluturonin
Patet e egra
Në formën e shkronjës “V”
Fluturonin në drejtim të hënës
Së mermertë

Asnjë yll tjetër
Nuk i kalëronte meteorët
Secili njeri me yllin e vet
Largohej nga atdheu
I cili qante si një kërthi i braktisur

Vetëm lehjet e qenve
Disi dukeshin si një melodi e harruar
Lehnin edhe yjet
Edhe unë në kuartet fillova me lehjen time
Mëngjesi kishte ikur prej lagjes së evgjitëve

ADEM ZAPLLUZHA

SECILI NJERI ME YLLIN E VET

Mbrëmë i pashë kah fluturonin
Patet e egra
Në formën e shkronjës “V”
Fluturonin në drejtim të hënës
Së mermertë

Asnjë yll tjetër
Nuk i kalëronte meteorët
Secili njeri me yllin e vet
Largohej nga atdheu
I cili qante si një kërthi i braktisur

Vetëm lehjet e qenve
